

Parlament
Organet e pavarura s'ka kush i kontrollon



PËRFUNDON "TANKU"

Gruevski 2 vite burg, Popovski edhe 6 të tjera



Gjuha për shpresë

Forum



Koha



I uritur për fitore

EDITORIAL

Prapagrilosja e Gruevskit, standard për pushtetet e ardhshme



Në CV-në e Nikolla Gruevskit do të shtohet edhe një kapitull i pasur dhe nxënësit e ardhshëm mund të lexojnë nëpër libra se Maqedonia ka pasur një kryeministër dallaverexhi që ka keqpërdor pozitën zyrtare për favore personale. Ai u dënua dje me 2 vite e 6 muaj vite burg me akuzë për veprën "pranim të dhuratës në bazë të ndikimit të jashtëligjshëm", lidhur me... Fq.2

FEJTON

Krimet e forcave irakiane, e njëjta metodë si e ISIS-it

FORUM

"Ambalazha" dhe përmbajtja e "Ilindenit"



RRËFEHET HAKI AZIRI

"MONSTRA" U MONTUA NJËJTË SIKURSE SOPOTI



Keqtrajtimi dhe marrja në pyetje e Hakiut nga inspektorët e MPB-së, nga 1 maji e deri më 8 maj 2012, është zhvilluar në lokacione të ndryshme, duke filluar nga Autokomanda, në ndërtesën e MPB-së apo atë të DSK-së e deri në objektet e fshehta të policisë në qytetin e Koçanit. Njëjtë sikurse keqtrajtimi i Ramadan Bajramit në rastin e Sopotit

Emri, palët i kthehen Nimicit

Shkup, 23 maj - Qëndrimi i Qeverisë në lidhje me propozimin e fundit për emrin "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është i pandryshuar, ndërsa mbetet të presim për pritjet nga takimin i së enjtes (sot) mes ministrave të Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias. Do të kemi informacion zyrtar që do ta ndajmë me opinionin. Kështu tha të mërkurën zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, në

konferencë për shtyp, duke u përgjigjur në pyetjen çfarë janë pritjet nga takimi i Nju-Jorkut. "Qëndrimi i Qeverisë që e transmetuan kryeministri Zaev dhe ministrat Shekerinska dhe Dimitrov mbetet i njëjtë. Konsiderojmë se propozimi i dhënë nga ana jonë pas takimit të liderëve i pasqyron në përgjithësi të gjitha aspektet që nevojiten që të mbrohet identiteti edhe i popullit të Maqedonisë..." Fq.4



EDITORIAL

PRAPAGRILOSJA E GRUEVSKIT, STANDARD PËR PUSHTETET E ARDHSHME



Emin AZEMI

Në CV-në e Nikolla Gruevskit do të shtohet edhe një kapitull i pasur dhe nxënësit e ardhshëm mund të lexojnë nëpër libra se Maqedonia ka pasur një kryeministër dallaveraxhi që ka keqpërdorur pozitën zyrtare për favore personale. Ai u dënua dje me 2 vite e 6 muaj vite burg me akuzë për veprën "pranim të dhuratës në bazë të ndikimit të jashtëligjshëm", lidhur me rastin e njohur "Tanku" që kishte të bënte me blerjen e një Mercedesi luksoz rreth 580 mijë euro me para të buxhetit të MPB-së, në vitin 2012. Pra, prej dje historia më e re e Maqedonisë, përpos tundjeve lartë e poshtë rreth emrit, do të pësojë edhe një korigjim në pjesët ku flitet për kontributin patriotik të Gruevskit në ndërtimin e Maqedonisë moderne, duke shtuar edhe disa pasuse që do të flasin për rolin e tij në rrënimin e këtij shteti. Është po ai politikan që më shumë se një dekadë instaloi në Maqedoni ideologjinë e tij - "gruevizmin", pluhurin më të ngjishëm në lëkurën e lagur me "rrëshirat" e një patriotizmi të kamufluar. Politikanët si Gruevski gjithmonë kanë ditur ta përdorin patriotizmin si dorëz higjienike për të përzier fëlliqësirat më të mëdha. Ai dhe të ngjashmit në këtë tranzicion të stërzgatur pasuruan vetveten në emër të kauzave që ata i legjitimonin si populllore, ndërkohë që populli vazhdonte të varfërohej dhe për rrjedhojë ai shndërrohej në makinë të pavullnetshme që votonte me automatizëm.

Kështu arriti të ndërtojë "kallëpin" e tij prej lideri edhe Nikolla Gruevski, duke detyruar edhe të tjerët që të futen në këtë kallëp. Ata që nuk u futën në këtë kallëp, sot e udhëheqin Maqedoninë, kurse të tjerët ose alivanosen para Gjykatës, ose bëjnë parada opozitare në Parlament. Gruevski do të përgjigjet për një pjesë të dallaveve të tija financiare. Në sirtarët e gjykatave po presin edhe 5, 6 lëndë të tjera që e ngarkojnë atë me fajësi të trashë. Dhe ky është një lajm i mirë. Sistemi gjyqësor përfundimisht filloi të dënoj politikanët për vepra që lidhen me marrjen e pushtetit peng. Në këtë trashësi dosjesh kri-

minale do të gjejnë "hije" edhe shumë kriminelë të tjerë të pushtetit të Gruevskit, në mesin e të cilëve edhe disa që kishin pikëpamje të hapura raciste kundër shqiptarëve. Gordana Jankulovska do ta quaj veten të pafat që nuk arriti "t'i rrafshojë" shqiptarët për njëzetë e katër orë, mirëpo fatkeqësia e saj qëndron në favorizimin që iu bënte demonëve kur parashikonte politikën. Ajo bashkë me njerëzit me të cilët punoi, përfshi edhe shefin e saj Gruevskin, e kishin projektuar shtetin si një rezervat ku do të kultivohehin instinktet e tyre primitive për të poseduar atë që s'iu takonte. Ajo që iu mungonte të tjerëve, ata e quanin pasuri familjare. Mafia ndryshe s'është. Ata, shtetit të tyre, Maqedonisë, ia morën kuptimin e marrjes me politikë të ndershme dhe instaluan hajdutokracinë në dëm të qytetarëve, në dëm të ardhmërisë, të cilën pretendonin se e kishin zaptuar si një grusht gjethesh në herbarium.

Degruevizmi as që ka filluar. Kryeministri Zaev ende po taktizon në betejat e tij politike në emër të njëfarë mirëkuptimi dhe pajtimi brendakombëtar. Në institucionet aktuale qeveritare ka plotë kuadro nga epoka e Gruevskit dhe disa madje janë bërë edhe këshilltarë të kryeministrit. Një dihotomi institucionale që mund të ketë kosto për vetë kursin e pretenduar të reformave që Zaevi është zotuar se do ti shpie deri në fund. Por të bësh reforma me bashkëpunëtorit e banorit më të ri të Idrizovës, tingëllon jo më pak naive. Kryeministri pajtimin më të madh brendakombëtar e ka bërë në momentin kur e ka mposhtur politikisht regjimin e Gruevskit dhe kur ka vendosur të projektojë një qeverisje reformuese. Gjithçka tjetër që mund të kuptohet si përpjekje për të amnistuar segmente të caktuara të regjimit të Gruevskit, do të ishte bumerang për vetë kryeministrin Zaev dhe një tallje me mbështetësit e tij.

Prapagrilosja e figurës së Gruevskit si politikan është korniza më e re e një pamjeje të cilën Maqedonia duhet ta fiksojë si motiv për galeritë e ardhshme të pushteteve.

PAS LAJMIT TË FRIKSHËM

"Sapo është dhënë lajmi me paralajmërimin e frikshëm se, në Shqipëri, numri i njerëzve që vdesin është më i madh se numri i fëmijëve që lindin. Për këtë bilanc negativ u numëruan shkaqe të ndryshme, ndër to emigrimi. Por natën e mbrëmshme m'u shfaq një Engjëlli, që më pëshpëriti edhe një shkak tjetër të rëndësishëm.

Mesazhi i tij ishte: Në këtë vend ka shumë më tepër njerëz që u drejtohen dyerve të burgjeve, dyerve të gjykatave për divorce, dyerve të kazinovave dhe lojërave të fatit, sesa dyerve të Librarive. Me gjasë, shtoi Engjëlli, në Shqipëri ka shumë më tepër shkruar, sesa lexues.

E megjithatë, iu përgjigja, edhe pse shpesh shkruhet me tepri e me babëzi, ajo që lexojmë dhe sidomos çfarë lexojmë, mbetet gjithmonë e pamjaftueshme.

M'u duk se këtë plotësim të mesazhit te tij, Engjëlli ma miratoi.

Dhe ishte pikërisht ai, të cilin në një status të mëparshëm e kam quajtur "Engjëlli i Leximit", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, shkrimtari shquar nga Tirana, Zija Çela.



MANIPULIMI ME BESIMET

"E di që nuk jam me i mençuri në këtë vend, po edhe e di se, të korrupuarit e pushtetit, për të vazhduar edhe me tej pa brenga në rrugën e tyre, do të donin që i gjithë populli të merrej me ngatërresa për besimet., cili është më i mirë e cili më i keq, cili pejgamber ka qenë me afër me Zotin e cili me larg, po unë nuk kam kohë të merrem me tema të tilla", ka shkruar në profilin e tij në Facebook studiuesi nga Prishtina, Sali Bytyçi.



PSE GJITHË KJO FUSHATË KUNDËR GJUHËTARIT KOLEC TOPALLI?

"Nuk më ka rënë ende në dorë 'Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe' i akademik Kolec Topallit, për të cilin po bëhet shumë zhurmë. Di vetëm që Profesor Kolec Topalli është personalitet shkencor.

Më vjen shumë keq që trajtohet sikur të ishte 'armiku' më i madh i shqiptarëve...

I nderuari Kolec Topalli kishte punuar gjashtë vjet në këtë vepër, por në të, siç e ka thënë autori, është përfshirë puna e tij 45 vjeçare në fushat e ndryshme të historisë së gjuhës', ka shkruar një status në Facebook, shkrimtari dhe pedagogu dr. Saladin Saliu.




NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE KOTO HOXHI?

Koto Hoxhi (Kostandin Hoxhi, 1824-1895) ishte veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare, i arsimit e i kulturës shqiptare, Mësues i Popullit. Lindi në Qestorat të Lunxhërisë (Gjirokastër), ku më pas punoi si mësues i shkollës së mesme në gjuhën greke, duke dhënë fshehurazi shqipen. Më 1879

mori pjesë në komisionin e posaçëm të Komitetit të Stambollit, që u formua për shqyrtimin e çështjes së alfabetit, ku mbrojti variantin e hartuar nga Sami Frashëri, si dhe në botimin e "Alfabetares" së Stambollit. Koto Hoxhi njihet gjithashtu si një nga themeluesit e teatrit shqiptar. Për veprimtarinë e tij patriotike



u burgos dhe u përdoq nga qeveria osmane dhe kisha fanariote.

MEDIA Citate

"TREPÇA" DHE GAZIVODA NË PAZARIN E ASOCIACIONIT

Dy nga resurset më të mëdha të Kosovës janë përfshirë në diskutimet e Ekipit Menaxhues në kuadër të hartimit të statutit të Asociacionit të Komunave me shumicë serbe.

"Trepça", e cila funksionon e ndarë dhe liqeni i Gazivodës kanë qenë objekt diskutimi në takimin e radhës të Ekipit menaxhues, që në rend dite ka pasur zhvillimin ekonomik. Aty kanë marrë pjesë drejtori i Gazivodës, Srgjan Vulović dhe drejtori i "Trepçës" në veri, Jovan Dimiq.

Një pjesë e "Trepçës" dhe Gazivoda, të cilat Kosova i konsideron ndër resurset me rëndësi strategjike, gjeografikisht janë në veriun e vendit, të populluar me shumicë serbe. Siç raportojnë mediet lokale në veri, në takim është kërkuar të mos vihen pengesa në funksion të zhvillimit ekonomik, "si parakusht i rëndësishëm për mbijetesën e popullit serb në Kosovë".

Gazeta ka pyetur në kabinetin e Haradinajt nëse janë në dijeni për ato që janë diskutuar në takimin e së hënës, por ka munguar përgjigjja. Sqarime nuk janë ofruar as nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila mbikëqyr procesin e hartimit të statutit. Por kreu i këtij dikasteri, Ivan Todoseviq, i cili vjen nga radhët e Listës Serbe ka qëndrim ndryshe prej kryeministrit Haradinajt kur është fjala për Asociacionin.

Përmes një deklarate dhënë medieve serbe, ai ka kërkuar përshtatjen e ligjeve të Kosovës për Asociacionin duke paralajmëruar se udhërrëfyes për hartimin e statutit i kanë marrëveshjet e Brukselit, por jo edhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka gjetur shkelje në të shtatë kapitujt e marrëveshjes së gushtit të vitit 2015.

(Koha Ditore, 23 maj)

PARLAMENTI LEJON VONESËN E RAPORTEVE VJETORE

ORGANET E PAVARURA S'KA KUSH I KONTROLLON

Përrjashtoj raportet për Prokurorinë Speciale Publike dhe Avokatin e Popullit, që zgjuan debat në publik, e njëjta nuk ndodh me raportet vjetore të komisioneve dhe agjencive të pavarura shtetërore. Zakonisht, puna e trupave të pavarur rregullator ka qenë objekt i kritikave të partive opozitare, por që kur kanë ardhur në pushet - nuk janë shquar për transparencën e këtyre organeve

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 23 maj - Në Parlamentin e Maqedonisë është bërë praktikë një kohë të gjatë që trupat e pavarur rregullator të raportojnë për punën e tyre deri gjashtë muaj me vonesë apo më shumë se kaq. Përrjashtoj raportet për Prokurorinë Speciale Publike dhe Avokatin e Popullit, që zgjoi debat në publik, e njëjta nuk ndodh me raportet vjetore të komisioneve dhe agjencive të pavarura shtetërore.

Zakonisht, puna e trupave të pavarur rregullator ka qenë objekt i kritikave të partive opozitare, por që kur kanë ardhur në pushet - nuk janë shquar për transparencën e këtyre organeve. Kjo ka ndodhur siç duket më shumë për shkak të delegimit të ushtarëve partiak në Këshillat drejtuese dhe nga ana tjetër, deputetët nuk kanë dashur shumë të turbullojnë ujin për punën e tyre dhe rrallë kanë ndodhur që të mos votojnë raportet vjetore të trupave rregullator. Kryetari i Komisionit parlamentar për mbrojtje dhe siguri, Hari Lokvenec, deputet i LSDM, pranon faktin se tek trupat rregullator ka dobësi të shumta në udhëheqje, ndonëse sipas tij, rregullativa ligjore është në masë e standardizuar me rregullativën e BE-së.

Ai e merr shembull Raportin e Ribes, ku hasen kritika për Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Agjencinë për Komunikime Elektronike. "Nuk mund të përrjashtohen gabimet as në delegimin e anëtareve në Këshillat drejtues, por ju e dini si kanë vepruar VMRO për dhjetë vite, duke partizuar çdo gjë në shtet. Ne po mundohemi të realizojmë si duhet funksionin kontrollues të Parlamentit, por ende ka shumë punë



VMRO BRAKTISI Mbledhjen Parlamentare

Pas shqiptimit të aktvendimit për ish-kryeministrin dhe ish-liderin e VMRO-DPMNE-së, Nikolla Gruevski për rastin "Tanku", deputetët nga kjo parti e braktisën mbledhjen e 46-të plenare të Parlamentit. Paraprakisht Parlamenti nuk i votoi ndryshimet e Ligjit për akcizat, propozuar mu nga deputetët opozitarë. Me këto ndryshime propozohet ulja e akcizës së derivateve disel për tre denarë për litër nga 15,121 denarë në 12,121

denarë për litër dhe ulje të akcizës së vajit që përdoret si derivat për ngrohje përkatësisht naftës së kuqe për tre denarë për litër nga 6,136 në 3,136 denarë për litër. Me ndryshimet në të vërtetë kërkohet kthimi i çmimit të vjetër të diselit, me çka do t'u dilej përballë qytetarëve duke pasur parasysh, që sipas tyre, rritja e çmimit të diselit negativisht është reflektuar ndaj buxhetit të çdo familjeje.

QEVERIA ME VLERËSIM NEGATIV PËR RTVM DHE AGJENCINË PËR MEDIA

Raporti vjetor i Radio Televizionit të Maqedonisë për vitin 2017 mori vlerësim negativ nga Qeveria gjatë seancës së fundit të saj. Qeveria ka vendosur të jap vlerësim negativ edhe në Raportin për këtë vit lidhur me funksionimin e Agjencisë për Shërbime Audio-Vizuale. Këto raporte të Qeverisë do t'i dorëzohen Parlamentit, ku dhe duhet të votohen. Duke pasur parasysh vlerësimin e Qeverisë, pritet që deputetët të mos miratojnë

këto raporte vjetore. Si rezultat i këtyre vlerësimeve negative të Qeverisë për funksionimin e Radio Televizionit të Maqedonisë dhe Agjencisë për Shërbime Audio-Vizuale, mund të kërkohet dorëheqje e kërërve të këtyre institucioneve ose të shkarkohen nga postet e tyre. Radio Televizionin e Maqedonisë dhe Agjencinë për Shërbime Audio-Vizuale vazhdojnë t'i udhëheqin kuadro të VMRO-DPMNE-së.

për tu bërë. Një hap të madh kemi bërë me standardizimin e raporteve vjetore, ndërsa më pas do të shohim me ndryshimin e rregullores që të mundën deputetët të kenë mekanizma kontrollues përmes vizitave në këto trupa apo në forma tjera të njihen më për së afërmi me punën e tyre", thotë Lokvenec.

Siç thotë ai, edhe përrskaj agjendës së ngarkuar të garniturës qeverisëse për çështjen e emrit dhe reformat në vend, kjo - thotë Lokve-

nec, nuk u pengon të kërkojnë performancë më të mirë në trupat e pavarur rregullator. Në këtë drejtim, sipas tij, duhet punuar më shumë tek Komisioni për antikorrupsion me qëllim që të pengohet korrupsioni dhe nepotizmi në trupat e pavarur rregullator.

Fadil Zendeli nga Lëvizja BESA thotë se ndër partitë që shquhet më shumë për ushtarë partiak në udhëheqjen me trupat rregullator - është pikërisht BDI. "Siç e dimë, deputetët nuk janë lëshuar shumë

në biografite personale nëse ka dikush shkollim përkatës specializimi në fusha specifike, por a është i dëgjueshëm i partisë dhe nëse u shkon për shtati funksionarëve partiak. Kjo ka bërë që VMRO çfarë ka dashur ka bërë në terrenin e vet dhe nga ana tjetër, BDI-së nuk i ka kërkuar llogari për punën apo mos punën e trupave rregullator, por vetëm për zhatjen e parave", thotë deputeti Zendeli.

Ai thekson më tej se nuk sheh se ka lëvizje për të mirë në drejtim

të kontrollit dhe mbikëqyrjes së mirëfilltë në punën e trupave rregullator. "Edhe Qeveria tani hesht edhe pse këta trupa janë të themeluar dhe i përgjigjen Parlamentit, ajo mundet në çdo kohë të vizitojë ato dhe të njihet me brendinë e funksionimit tyre. Kjo nuk ndodh për shkak se dikush i afërt i ndonjë ministri apo funksionari të lartë partiak është anëtar në borde drejtuese", thekson Zendeli.

Por me kritikën e Zendelit nuk pajtohet shefi i grupit parlamentar të BDI-së, Ejup Alimi. Sipas tij, partitë shqiptare opozitare flasin kot për njerëz të deleguar të BDI-së pa dhënë ndonjë analizë, siç thotë ai, të bazuar në të dhëna konkrete për punën apo mos punën e dikujt në ato trupa. "Partitë shqiptare opozitare shpesh ndodh që nuk dinë çka flasin, lëshojnë llafe kot se BDI nuk çon ekspertë apo njerëz adekuat në komisione të pavarura. Besoni, ata nuk i dinë dhe as nuk kanë haber se çfarë punojnë komisionet apo Agjencitë e pavarura. Nuk i dinë kompetencat e tyre, as nuk kanë njohur se çfarë biografi kanë njerëzit që ka deleguar BDI. Ata dinë vetëm të thonë 's'bën aty e s'bën këtu', pa dhënë ndonjë analizë të bazuar në punën apo mos punën e dikujt. Meqë nuk dinë, prandaj edhe janë aty ku janë", thotë Alimi nga BDI.

Ndryshe të mërkurën në seancë plenare është votuar për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për Letra me Vlerë kur për kryetar është propozuar ish-deputetja e BDI-së, Nora Haliti. Përveç kësaj, në seancë plenare ka nisur shqyrtimi i Raportit vjetor për punën e Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017; Raport për aktivitetet e Prokurorisë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes së paligjshme të komunikimeve për periudhën prej gjashtë muajsh (për periudhën prej 15.09.2017 deri më 15.3.2018); Raporti vjetor për punën e Komisionit për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë të Informatave me Karakter Publik për vitin 2017; Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë për vitin 2017; Raport vjetor për punën e Agjencisë së Administratës për vitin 2017; Raport vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Shkallë të Dytë në Sferën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës së Kundërvajtjes për vitin 2017; Raport vjetor i Avokatit të Popullit për shkallën e sigurimit të respektimit, avancimit dhe mbrojtjes së lirisë dhe të drejtave të njeriut për vitin 2017.

INTERESIM I MADH PËR MJETET NGA PLANI PËR ZHVILLIM EKONOMIK

Interesimi për shfrytëzimin e granteve bashkëfinansuese për ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme të siguruara në pajtim me Planin qeveritar për rritje ekonomike është i madh. Pritet të gjitha mjetet e siguruara në lartësi prej 10 milionë eurosh të ndahen që në thirrjen e parë, që përfundon më 11 qershor. "Deri më sot mbi 320 kompani, mikro, të vogla dhe të mesme kanë marrë pako aplikuese. Deri në skadimin e shpalljes më 11 qershor do të ketë numër të madh të kompanive të cilat do të paraqiten dhe të do të tregojnë interes për përdorimin e mundësive të

cilat ofrohen në planin për rritje ekonomike. Vëllimi i përgjithshëm i mjeteve të ndara është 645 milionë denarë. Edhe pse fillimisht planifikonim mjetet t'i ndajmë në tre thirrje, pas interesimit të deritanishm, pres pjesë më të madh apo të gjitha mjetet t'u ndahen kompanive", tha drejtori i Fondit për Inovacione dhe Zhvillim Teknologjik, Jovan Despotovski. Ai paralajmëroi se për shkak të interesimit të madh për përdorimin e llojit të tillë të mjeteve në vijim janë negociata për sigurimin e mjeteve plotësues për publikimin e thirrjes së tillë në shtator të këtij viti.

NISIN BISEDIMET NË NJUJORK

EMRI, PALËT I KTHEHEN NIMICIT

Në vigjilje të raundit të ri të bisedimeve në Nju-Jork, sot dhe nesër, shefi i diplomacisë greke tha se paralelisht me negociatat kryesore, do të mbajnë mbledhje grupet teknike, ndërsa i përmendi edhe dy tekstet, njërin nga pala greke, tjetri nga ndërmjetësi, të cilët i përmbajnë pikat, për të cilat zhvillohen bisedime

Shkup, 23 maj - Qëndrimi i Qeverisë në lidhje me propozimin e fundit për emrin "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është i pandryshuar, ndërsa mbetet të presim për pritjet nga takimin i së enjtes (sot) mes ministrave të Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov dhe Nikos Koxias. Do të kemi informacion zyrtar që do ta ndajmë me opinionin. Kështu tha të mërkurën zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, në konferencë për shtyp, duke u përgjigjur në pyetjen çfarë janë pritjet nga takimi i Nju-Jorkut.

"Qëndrimi i Qeverisë që e transmetuan kryeministri Zaev dhe ministrat Shekerinska dhe Dimitrov mbetet i njëjtë. Konsiderojmë se propozimi i dhënë nga ana jonë pas takimit të liderëve i pasqyron në përgjithësi të gjitha aspektet që nevojiten që të mbrohet identiteti edhe i popullit të Maqedonisë, megjithatë i pasqyron edhe të gjitha pjesët tjera që e shënojnë Maqedoninë si shtet multi-etnik. Konsiderojmë se ky është propozim i mirë për zgjidhje përfundimtare", tha Boshnjakovski. Në ndërkohë, është shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias ai që nga Nju Jorku ka theksuar se administrata amerikane nuk kryen presion, por interesohet për zgjidhje drejt së cilës çojnë bisedimet për emrin dhe cilat janë pikat më të vështira.

AMERIKANËT TË INTERESUAR PËR ZGJIDHJE

Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë u takua me këshilltarin për siguri nacionale të presidentit amerikan, Xhon Bolton, ndërsa mbledhja ka zgjatur dyfish më tepër sesa e parashikuara. Edhe Bolton edhe Pompeo, siç tha Koxias, i kanë dëgjuar pozicionet greke, si për rajonin, Lindjen e Afërt, ashtu edhe për sigurinë e Greqisë me Turqinë dhe kanë biseduar për emrin, për të cilat ka bise-



EDHE KATRUGALOS KËRKON NDRYSHIME KUSHTETUESE

Në raport të asaj se nëse nuk zgjidhet çështja me revizionin kushtetues, marrëveshja nuk do të vijë në Parlamentin grek. Me Kamenos nuk kemi pozita të ndryshme, thotë ministri alternativ i Punëve të Jashtme, Jorgos Katrugalos, duke i komentuar deklaratat e liderit të Greqëve të Pavarur dhe partneri koalicionit në Qeverinë greke, Panos Kamenos. "Kamenos qartë tregon se nëse nuk zgjidhet çështja me revizionin kushtetues, ndërsa pala tjetër nuk e kryen atë obligim, marrëveshja nuk do të vijë në



Parlament dhe ajo është e vërtetë. Ne konsiderojmë se zgjidhja e erga omnes, pranimit i përgjithshëm i emrit brenda dhe jashtë me revizion kushtetues është një nga parakushtet e pakos së marrëveshjes. Kjo është diçka që edhe ne e kemi potencuar dhe për këtë nuk kemi dallime me Greqët e Pavarur", thotë Katrugalos dhe shton se në raport të mospranimit të emrit të ndërlikuar me termin Maqedonia nga Panos Kamenos, ajo është diçka që kryetari i Greqëve të Pavarur, e ka thënë edhe në të kaluarën.

duar me ndihmës-sekretarin shtetëror Ues Miçell.

"Në çështjen e Shkupit nuk kemi kurrfarë presioni, as dikush nuk e ka ndërmend të na bëjë presion. Nuk do të lejomë asnjëherë të na bëjnë presion. Por, interesohen shumë për zgjidhje dhe përpiqen të kuptojnë ku ndodhen bisedime dhe cilat janë pikat e vështira", tha Koxias dhe shtoi se përvoja ka treguar që ndërmerren nisma, atëherë nuk mund të përzihet askush. Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, potenco se në lidhje me Shkupin, është në konsultim të vazhdueshëm dhe në bashkëpunim me kryeministrin grek, me të cilin kanë përputhje të qëndrimeve. Në vigjilje të raundit të ri të bisedimeve në Nju-Jork, sot dhe nesër, shefi i diplomacisë greke tha se paralelisht me negociatat kryesore, do të mbajnë mbledhje grupet teknike, ndërsa i përmendi edhe dy tekstet, njërin nga pala greke, tjetri nga ndërmjetësi, të cilët i përmbajnë pikat, për të cilat zhvillohen bisedime.

KOVAÇEV: PROPOZIMI "ILINDITASE" NA BEFASOI

I habitur ndërkohë me propozimin "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" është shprehur edhe eu-

rodeputeti bullgar, Andrej Kovaçev. "Propozimi 'Republika Ilinditase e Maqedonisë' na befaso dhe askush nga ne në Bullgari nuk është konsultuar. Është shumë me rëndësi interpretimi i tij, nëse aludon në të parin Ilinden ose në atë të dytin, komunist", deklaroi Kovaçev, sipas të cilit, kontesti shumëvjeçar rreth emrit do të mund të zgjidhet vetëm nëse të dyja palët, Maqedonia dhe Greqia, vendosin që të ndalojnë provokimet.

Për eurodeputetin bullgar, emri më i përshtatshëm do të ishte Republika e Maqedonisë (Shkup), duke e pasur parasysh se është e qartë kërkesa greke për përcaktim gjeografik ose kohor. "Nëse me

propozimin Republika Ilinditase e Maqedonisë mendohet në atë të dytin, Ilinden komunist, gjegjësisht KAÇKM, nuk jemi shumë të gëzuar", theksoi eurodeputeti bullgar.

Vlerësimi i tij është se për shkak të Qeverisë së Gruevskit, Maqedonia ka humbur njëmbëdhjetë vjet dhe nuk ka bërë asgjë për zgjidhjen e kontestit. "Më vjen keq që Maqedonia ka humbur ndoshta 11 vjet në bërjen asgjë. Kishte ngecje gjatë qeverisjes së Gruevskit dhe nuk është bërë asgjë madje situata me Greqinë dhe Bullgarinë u bë edhe më keq. Tani, dritarja e mundësive dhe vullneti i mirë i Zoran Zaevit dhe Nikolla Di-



ANDREJ KOVAÇEV

Propozimi 'Republika Ilinditase e Maqedonisë' na befaso dhe askush nga ne në Bullgari nuk është konsultuar. Është shumë me rëndësi interpretimi i tij, nëse aludon në të parin Ilinden ose në atë të dytin, komunist. Nëse me propozimin Republika Ilinditase e Maqedonisë mendohet në atë të dytin, Ilinden komunist, gjegjësisht KAÇKM, nuk jemi shumë të gëzuar. Emri më i përshtatshëm do të ishte Republika e Maqedonisë (Shkup), duke e pasur parasysh se është e qartë kërkesa greke për përcaktim gjeografik ose kohor

mitrovit e kanë ndryshuar lojën. E vlerësojmë shumë këtë dhe shohim zhvillim shumë pozitiv në marrëdhëniet me ne. Mundohemi ta nxitim Greqinë ta ndjekë shembullin tonë dhe të gjejë një zgjidhje të pranueshme për emrin me Maqedoninë", përmendi Kovaçev. Kjo periudhë e gjatë prej të paktën 20 viteve, siç tha eurodeputeti, e ka rritur në njëfarë mënyrë ekstremitetin në qëndrimin e dy palëve. Ai porosi se do të ishte mirë që partitë më të mëdha opozitare në dy vendet t'i mbështetin strukturat qeveritare në drejtim të tejkalimit të kontestit. "Nëse Cipras dëshiron të bëjë diçka, Kamenos, Micotakis... thonë 'jo, jo, jo'. Kjo është shumë keq nëse partia më e madhe opozitare në vend e shfrytëzon problemin me emrin për duele të brendshme politike. E njëjta vlen edhe për Maqedoninë, për VMRO-DPMNE-në dhe për LSDM-në", tha eurodeputeti bullgar.

EMRI, BISEDË TELEFONIKE MERKEL-ZAEV

Kryeministri Zoran Zaev ka biseduar në telefon me kancelaren gjermane Angela Merkel, e cila dha mbështetje për gjetjen e zgjidhjes së pranueshme të përbashkët për kontestin me Greqinë rreth emrit. Merkel pati takime të ndara me Zaevin dhe me kryeministrin grek Aleksis Cipras në margjinat të Samitit BE-Ballkani Perëndimor, që u mbajt javën e kaluar në Sofje, ndërsa për rëndësinë të cilën ajo ia kushton kontestit, tregon edhe ajo që konferencën për shtyp në Sofje e filloi mu me përshëndetjen për përpjekjet që i bëjnë të dyja vendet për të gjetur zgjidhje për emrin. Me kancelaren Merkel dje bisedoi në telefon edhe



kryeministri grek Cipras, lajmëroi radio Dojçe Vele. Kabineti i kancelares Merkel konfirmoi se ajo ka biseduar me dy kryeministrat, por nuk dha më tepër hollësi. Zaev dhe Cipras negociuan për emrin në margjinat të Samitit në Sofje, pas çka kryeministri i Maqedonisë deklaroi se kanë gjetur opsion i cili është i pranueshëm për të dyja palët. Pas takimit të liderëve këtë fundjavë Zaev e kumtoi opsionin - Republika e Maqedonisë së Ilindenit, ndërsa Kabineti i Ciprasit shkurtë pas kësaj doli me kumtesë në të cilën kërkoi që në emër të përmbahet përcaktimi kohor apo gjeografik.

RRËFEHET HAKI AZIRI

"MONSTRA" U MONTUA NJËJTË SIKURSE SOPOTI

Keqtrajtimi dhe marrja në pyetje e Hakiut nga inspektorët e MPB-së, nga 1 maji e deri më 8 maj 2012, është zhvilluar në lokacione të ndryshme, duke filluar nga Autokomanda, në ndërtesën e MPB-së apo atë të DSK-së e deri në objektet e fshehta të policisë në qytetin e Koçanit. Njëjtë sikurse keqtrajtimi i Ramadan Bajramit në rastin e Sopotit



mitar të koduar, me çka brenda kohës së njëjtë, ai bëhet edhe i akuzuar. Kërcënimet e llojit se do t'ja vrasin tërë familjen dhe atë do ta zhdukun pa asnjë gjurmë, siç tregoi Hakiu para Trupit gjykues, kanë ndikuar që ai të pranojë çdo gjë që inspektorët e policisë kishin kërkuar.

"Gjatë bastisjes në shtëpi, dhunë dhe torturë nga policia është përdorur edhe ndaj babait dhe vëllait tim. Më pas më dërguan në stacionin policor në Autokomandë. Fillimisht për pyetjen për datën 12 prill. Deri atë kohë unë nuk e kisha idenë se për çka po arrestohem. Dhe, kur unë fillova të flasë për 12 prillin, e cila për mua deri atë ditë ishte një datë e

zakonshme, inspektorët e policisë ndërhyjnë dhe më thanë se unë bashkë me disa tjerë e kemi kryer vrasjen për të cilën akuzohemi edhe sot e kësaj dite. Kategorikisht i kam refuzuar këto akuza dhe çfarëdo qoftë lidhe me atë ngjarje. Kjo deklaratë atyre nuk ju pëlqeu, me çka filluan kërcënimet dhe ofendimet se më kanoset zhdukja e gjithë familje, pasi edhe ata janë arrestuar, së paku kështu më thanë", tha Hakiu.

Vazhdimi i marrjes në pyetje nga inspektorët e lartë të MPB-së, nga 1 maji e deri më 8 maj 2012, është zhvilluar në lokacione të ndryshme, duke filluar nga Autokomanda, më pas siç tha Hakiu, në ndërtesën e MPB-së apo atë të

Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim (DSK), e deri në objektet e policisë në qytetin e Koçanit. Në të shumtën e kohës, sipas deklaratës së dhënë të mërkurën, hakiu ka qenë i lidhur për karrige. Qëndrimin e tij në Koçanë, në një dhomë me grila - e ngjashme si qeli burg, në kohën kur atë kohë i gjithë opinionin nuk e dinte fatin e tij, Hakiu e përshkroi si një ferr të vërtetë, me çka njëri prej policëve i kishte thënë të flas me prindin, vetëm për t'i treguar se është gjallë dhe shëndosh.

"Kur më thanë të flasë me babën, më potencuan se duhet të jem i kujdesshëm se çka flas. Më pas të njëjtit inspektorë, si në Shkup ashtu edhe në Koçanë, më

ofruan para, ndërrim të identitetit, largim nga vendi. "Nëse dëshiron të dërgojmë në Holandë, atje i kemi njerëzit tanë", më thanë inspektorët. Kërkesa e vetme e tyre ishte që unë të pranoj se Halil Demiri me shokë e ka kryer këtë vepër. Dhe kështu i frikësuar, i kërcënuar, keqtrajtuar dhe i torturuar, pranova gjithçka që ata kërkuar. Të njëjtit më thanë se nuk ekziston për mua dalje nga kjo situatë, gjykatësit, prokurorët po edhe avokatët të gjithë janë njerëz të policisë", tregoi Hakiu.

Gjatë dy paraqitjeve para gjykatësit hetues, respektivisht më 2 dhe 7 maj të vitit 2012, Hakiu kishte rrëfyer skenarin e përgatitur nga policia për vrasjen e pesë të rinjve maqedonas më 12 prill. Ndërkohë, mundësia e parë që ju kishte dhënë atij, pas paraqitjes para Trupit gjykues, ai në detaje e kishte përshkruar të njëjtën deklaratë. Mes tjerash, ai edhe njëherë nuk e mohoi faktin se me të akuzuarit tjerë njëhej para datës 1 maj të vitit 2012.

Procesi gjyqësor për "Monstrën" i përfaqësuar nga PSP, së shpejti pritet të paraqitet me fakte dhe prova të reja. Rikualifikimi i aktakuzës, përfshirja e të akuzuarve tjerë, ku nuk përjashtohen gjykatës, prokuror dhe inspektor të policisë, mendohet të jetë pista e hetimeve në të cilën është duke punuar PSP-ja.

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 23 maj - Tortura dhe marrja në pyetje e Haki Azirit, i dënuar në rastin "Monstra", aspak nuk dallon nga metodologjia të cilën inspektorët e policisë e kanë përdorur edhe në rastin e "Sopotit". Në rifillimin e procesi gjyqësor për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës, Aziri nga e para e sqaroi përjetimin e tij nga 1 maji i vitit 2012 e këndej. Fillimisht, atë kohë, Prokuroria për krim të organizuar Hakiun e kishte përfshirë si dësh-

JEPET AKTVENDIM PËR MERCEDESIN

GRUEVSKI DY VITE BURG, POPOVSKIT EDHE 6 TË TJERA

Sipas aktvendimit, të lexuar nga gjykatësja Kacarska, ish-kryeministri Gruevski ka ushtruar ndikim ndaj dy të akuzuarve të tjerë në mënyrë që nga Gordana Jankullovska, ndërkaq, e ka nxitur Gjoko Popovski gjatë blerjes së automjetit ta favorizojë operatorin ekonomik "Mak Auto Star"



• Para Gjykatës së re penale ishin tubuar rreth 20 mbështetës së Gruevskit, mes të cilëve ishte edhe ish-kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, ish kryetari i Komunës së Aerodromit, Ivica Konevski

la Gruevski, si nxitës për kryerjen e veprës është dënuar me dy vite burg. Popovski është i dënuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, përderisa Gruevski për përfitim të dobisë personale dhe nxitje për kryerje të veprës penale.

Gjykatësja Dobrilla Kacarska gjatë shqiptimit të aktvendimit

tha se dy të dënuarit duhet në afat prej 15 ditëve pas hyrjes në fuqi të aktvendimit ta kompensojnë dëmin e krijuar në këtë rast.

Ish-kryeministri Gruevski nuk erdhi në shqiptimin e aktvendimit për rastin "Tanku", por u përfaqësua nga mbrojtësit e tij Sanja Aleksiq, Dimitar Dangov dhe Boro Ta-

sevski. I akuzuari i parë Popovski, me pranga në duar nga burgu hetues Shkup u soll në gjykatë. Një ditë më parë, si ish-ndihmës ministër i Punëve të Brendshme, u dënuar me nëntë vite burg për keqpërdorim të pozitës zyrtare në lëndën e PSP-së "Treqind", për furnizimin e 300 automjeteve për MPB-në dhe

menjëherë ishte nisur në paraburgim, me kërkesë të PSP-së për shkak të rrezikut nga ilja.

Për të akuzuarën e tretë, Gordana Jankullovska, para një muaji procedura ishte ndarë dhe për të seanca është caktuar për më 28 qershor. Sipas aktvendimit, të lexuar nga gjykatësja Kacarska, ish-kryeministri Gruevski ka ushtruar ndikim ndaj dy të akuzuarve të tjerë në mënyrë që nga Gordana Jankullovska, ndërkaq, e ka nxitur Gjoko Popovski gjatë blerjes së automjetit ta favorizojë operatorin ekonomik "Mak Auto Star" SHPKNJ Shkup.

Para Gjykatës së re penale ishin tubuar rreth 20 mbështetës së Gruevskit, mes të cilëve ishte edhe ish-kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, ish kryetari i Komunës së Aerodromit, Ivica Konevski. Gjykata ishte siguruar me kordon policor, ndërsa që prej një nate më parë ishte rrethuar me rrethojë metalike me çka është kufizuar lëvizja rreth ndërtesës së gjykatës.

(O.Xh)

Shkup, 23 maj - Ish-ndihmës ministri i Punëve të Brendshme, Gjoko Popovski, dje në Gjykatën penale Shkup u dënuar me gjashtë vite e gjashtë muaj burg për lëndën "Tanku", konkretisht për mercedesin që kushtoi 600 mijë euro. I akuzuari i dytë, ish-kryeministri Nikol-

Më së shumti fëmijë jashtë martesë janë lindur tek prindër shqiptarë dhe romë, edhe atë nga gjithsej 2651 fëmijë të lindur jashtë martesë, 565 janë shqiptarë, 4714 romë, 247 maqedonas

Koha

Aida XHONI

Shkup, 23 maj - Në Maqedoni, sipas të dhënave zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikës (ESHS), rreth 12% nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të lindur janë jashtë martesë. Më së shumti fëmijë jashtë martesë janë lindur tek prindër shqiptarë dhe romë, edhe atë nga gjithsej 2651 fëmijë të lindur jashtë martesë, 565 janë shqiptarë, 4714 romë, 247 maqedonas.

Sipas ESHS-së, numri më i madh i foshnjave (88.4%) janë të lindur në lidhje martesore dhe mund të thuhet se ulja e fertilitetit është rezultat i vonimit të hyrjes në lidhje martesore tek moshat e rritura. "Nga numri i përgjithshëm, 2761 fë-

ESHS PUBLIKON TË DHËNAT E BASHKËSISË MARTESE

SHQIPTARËT TË PARËT PËR FËMIJË JASHTË MARTESE



mijë, ose 12 për qind janë të jashtë martesë", thotë Enti Shtetëror i Statistikave.

Pra, 88 për qind e foshnjave kanë lindur në bashkësi martesore. Nëna ishte në një moshë mesatare prej 28.9 vjetësh (dhe 27.2 vjet në lindjen e parë). Viti i lindjes i nënës, që shfaqet si më shpesh, është 1987.

Sipas sociologëve, përqindja më e madhe e fëmijëve të lindur jashtë lidhjeve marte-

sore është tek shqiptarët dhe romët, sepse shumë shpesh jetojnë në kurorëzim joformal, vetëm me kurorë fetare.

Ndryshe, numri i fëmijëve jashtë kurorëzimit në Evropë është rritur për dy herë më shumë në krahasim me periudhën para dy dekadave. Më së shumti fëmijë të lindur jashtë lidhjes martesore ka në Estoni, ndërsa më së paku në Greqi. Krahasuar me Maqedo-

ninë, Turqia dhe Greqia kanë një përqindje më të lartë të foshnjave të lindura në bashkësinë martesore. Në fqijun tonë, 90.6 foshnje kanë lindur në martesë. Nga anëtarët e BE, Franca udhëheq listën e fëmijëve të lindur jashtë martesë, ku gjashtë nga dhjetë foshnjat lindin jashtë martesë, ose 59.7 për qind.

Është interesante se pas Francës, përqindja më e lartë është te dy vende ballkanike - në Bullgari dhe në Slloveni. Në të dy vendet, përqindja e fëmijëve të lindur jashtë martesë është 58.6. Përqindja e lartë është shfaqur edhe në Estoni (51.6%), Suedi (54.9%), Danimarkë (54%), Portugali (52.8%) dhe Holandë (50.4%). Jashtë BE-së, Islanda, ndërkohë, foshnjave të lindura jashtë martesë, pak më poshtë se 70 për qind.

KRONIKË

Padi e re për ish-kryetarin e Vasilevës

SPB Strumicë parashtrori kallëzim të ri penal për ish-kryetarin e komunës së Vasilevës, Vanço Stojanov (51), si dhe kundër G.C. (55) nga fshati Dobroshincë. Sipas zëdhënësës së policisë së Strumicës, Hrizantema Rendevska, ish-kryetari i komunës dyshohet se ka kryer veprë penale "Keqpërdorimin e pozitës zyrtare dhe të autorizimit", ndërsa i denoncuari i dytë për "Stimulim". "V.S. më 27 shtator të vitit 2012 të denoncuarit të dytë i ka dhënë vendim për përcaktimin e statusit juridik për objektin-shtëpinë e ndërtuar në mënyrë të paligjshme, për objekt për të cilin nuk janë plotësuar kushtet për legalizim dhe përcaktimin e statusit juridik në pajtim me Ligjin për veprim për objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme", tha zëdhënësja e SPB Strumicë, Hrizantema Rendevska. Sipas policisë, ish-kryetari i komunës së Vasilevës me këtë ka vepruar në kundërshtim me Ligjin me çka i ka mundësuar të denoncuarit të dytë, i cili është i punësuar në Komunën e Vasilevës, të fitojë dobi pronësore të paligjshme.

Sulmohet 15-vjeçari nga Zhelina

33-vjeçari me iniciale N.S. nga fshati Strimnicë ka denoncuar se të martën diku rreth orës 13.30 minuta, është sulmuar nipi i tij 15-vjeçar nga fshati Strimnicë duke drejtuar veturën "Mercedes" me targa të Tetovës, në të cilën si bashkudhëtarë kanë qenë edhe katër persona tjerë të mitur nga i njëjti fshat. Duke vozitur nga fshati Zhelinë në drejtim të fshatit Pallaticë, veturën "Mercedes", e ka ndjekur një veturë tjetër e tipit "Opel Korsa" gjithashtu me targa të Tetovës, e drejtuar nga një 16-vjeçar nga fshati Zhelinë, në të cilën si bashkudhëtarë kanë qenë edhe katër persona të mitur nga i njëjti fshat. Përpara shkollës në fshatin Pallaticë, vetura "Opel Korsa" ka ndaluar, kurse drejtuesi ka dalë nga vetura dhe me shkop druri fillimisht ka dëmtuar veturën "Mercedes" dhe më pas ka sulmuar 15 vjeçar, si dhe njërin nga personat që kanë qenë në veturë, që më pastaj sulmuesit të largohen në drejtim të panjohur. Pesë minorenët nga fshati Zhelinë, në prezencë të prindërve të tyre, janë thirrur në stacion policor dhe po punohet në zbardhje të rastit, informoi policia e Tetovës.

Aksidentohet 67-vjeçari nga Reçica e Madhe

Të hënë mbrëma rreth orës 23.10 minuta, në rrugën "167" në Tetovë, vetura e tipit "Opel Korsa", me targa të Tetovës, e drejtuar nga 67 vjeçari J.A. nga Reçica e Madhe, ka aksidentuar këmbësorin me inicialin M.B. nga Tetova. Këmbësori i lënduar, me autoambulancë është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës për dhënie ndihmës mjekësore, ku është ndaluar për mjekim të mëtutjeshëm. Pas kryerjes së hetimeve, punohet në zbardhjen e plotë të rastit si dhe shkaqet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur rasti. (U.H)

Shkup, 15 aksidente për 24 orë

Shkup, 23 maj - Një udhëtar i një autobusi ishte lënduar rëndë në një prej gjithsej 15 aksidentëve të ndodhura gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në shtatë aksidente lëndime më të lehta kishin marrë tetë persona, ndërsa në shtatë të tjera ishte shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia ka zbuluar dhe ka sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Shtatëdhjetë e pesë shoferë kanë qarkulluar me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, pesë shoferë kanë kaluar në dritë të kuqe në udhëkryq, katër shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve në vendkalimin e shënuar, katër shoferë për parkim të parregullt, një shofer për parakalim të parregullt, pesë shoferë nuk u kanë dhënë përparësi kalimit të automjetit në zonën e udhëkryqit dhe tre shoferë për mospërdorimin e helmetës mbrojtëse. Janë sanksionuar edhe shtatë këmbësorë të cilët kanë kaluar në dritë të kuqe. Janë hasur edhe 95 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Nga komunikacioni janë përjashtuar katër shoferë të cilët i kanë drejtuar automjetet nën ndikim të alkoolit, 23 shoferë para se të marrin patentë shoferi, dy shoferë fillestarë, si dhe një automjet teknikisht i parregullt, 16 automjete të pargjistruara dhe një automjet për mbingarkesë. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit, janë mënjanuar 55 automjete. (O.Xh)

GJYKATA E TETOVËS U VAZHDON PARABURGIMIN TË ARRESTUARVE

AKTAKUZË PËR 13 PERSONA PËR VRASJEN NË REÇICË TË VOGËL



Shkup, 23 maj - Prokuroria Themelore Publike Tetovë ka ngritur aktakuzë kundër 13 personave për pjesëmarrje në incidentin e armatosur në Reçicë të Vogël, i cili ndodhi më 5 prill të këtij viti, në të cilin një person e humbi jetën Naip Rexhepi nga Kumanova, ndërsa i plagosur mbeti vëllai i Naipit të vranë, Sabit Rexhepi dhe Florim Misini nga fshati Çerkez.

"Kundër katër personave është ngritur aktakuzë me propozim për vazhdimin e masës së paraburgimit, me çka një person ngarkohet për vepra penale 'vrasje' dhe 'prodhimin, posedimin, ndërmjetësimin dhe tregtinë e paautorizuar të armëve ose materialeve shpërthyesë' nga Kodi Penal. Tre persona ngarkohen për vepra penale 'vrasje në përpjekje' dhe për 'prodhimin, posedimin, ndërmjetësimin dhe tregtinë e paautorizuar të armëve ose materialeve shpërthyesë' nga Kodi Penal", kumtoi Prokuroria Themelore.

Prokurori përkatës publik deri te Gjykata Themelore Tetovë propozoi që tre të akuzuarit, të cilët janë privuar nga liria, si dhe një të akuzuari i cili edhe më tutje është në arrati, tu

vazhdohet paraburgimi deri në hyrjen në fuqi të dënimit kundër tyre.

Kundër nëntë personave të tjerë Prokuroria e Tetovës ngriti padi me të cilën të gjithë akuzohen për veprë penale "pjesëmarrje në grindje" nga Kodi Penal. Për tetë të akuzuar, prokurori përkatës publik deri te Gjykata Themelore Tetovë dorëzoi propozim për caktimin e masave të sigurisë, përderisa për një person propozoi caktimin e masës së paraburgimit deri në hyrjen në fuqi të dënimit, sepse bëhet fjalë për shtetas të Republikës së Shqipërisë.

"Gjatë hetimit, prokurori publik vërtetoi se personat e akuzuar ishin pjesë e dy grupeve kundërshtare, të cilët pas një marrëveshje të mëparshme dhe për shkak të mos tolerancës së mëparshme mes vete, me vetura kanë ardhur në vendin e incidentit në Reçicë të Vogël. Pesë persona, në mesin e të cilëve edhe personi i ndjerë, ishin të armatosur me pistoletë, pas çka ka ardhur në konflikt të ndërsjellë verbal i cili kaloi në grindje dhe përdorim të armëve të zjarrit. Përveç pistoletave, në grindje ishin shfrytëzuar edhe shufra bejsbolli, thika dhe mjete të tjera", theksohet në kumtesën e Prokurorisë.

Aktakuza e Prokurorisë Themelore Publike Tetovë është mbështetur në materialin e grumbulluar të dëshmitë, rezultate nga një numër i madh i dëshmitë, analizave të gjurmëve në armët dhe gjurmë nga prejardhja biologjike, si dhe incizimet e siguruar nga kamerat mbikëqyrëse. (U.H)

ODA E NDËRTIMTARISË KËRKON ZGJIDHJE URGJENTE

NA NDIHMONI, NDËRTIMTARIA PARA KOLAPSI!

Ndërtimtarët kërkojnë që shteti urgjentisht të miratojë zgjatjen deri në vitin 2023 të pagesës prej 5 për qind të tatimit për blerjen e banesës së parë, si dhe të mos ketë vonesa gjatë dhënies së lejeve të ndryshme për ndërtim. Në të kundërtën, mund të pritët ulje e madhe e aktiviteteve ndërtimore, më pak të ardhura buxhetore në emër të tatimeve, si dhe lëshime nga puna në kompanitë e ndërtimit

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 23 maj - Çështja e emrit si dhe zgjidhja e problemeve të tjera politike, si reformat në gjyqësor, media, reformat në administratën publike..., sikur kanë lënë në plan të dytë mbështetjen konkrete dhe jo vetëm në letër të afaristëve për zgjerimin e bizneseve ekzistuese, por edhe për hapjen e bizneseve të reja. Bile, një pjesë e analistëve ekonomik thonë se kemi zvarritje të madhe të hapave konkret për të lehtësuar punën e përditshme të biznesit.

Të fundit që janë ankuar për vonesat në zgjidhjen e problemeve si burokratike ashtu edhe ato të tjera, janë ndërtimtarët që kërkojnë miratimin urgjent të zgjatjes ligjore deri në vitin 2023 të pagesës prej 5 për qind të tatimit për blerjen e banesës së parë, përqindje kjo që vlen deri më 31 dhjetor të këtij viti.

Ndërtimtarët kërkojnë gjithashtu të mos ketë vonesa gjatë dhënies së lejeve të ndryshme për ndërtim, si dhe respektimin e Planeve të Detajuara Urbanistike për projektet ndërtimore që kanë filluar të realizohen. Në të kundërtën, nga Lidhja e Odave Ekonomike e



Maqedonisë kanë paralajmëruar një ulje të madhe të aktiviteteve ndërtimore, që nënkupton edhe më pak të ardhura buxhetore në emër të tatimit personal, tatimit në vlerë të shtuar, lëshime nga puna në kompanitë e ndërtimit, ulje të shitjes së materialeve ndërtimore e kështu me radhë.

Gjithashtu, sipas tyre, rrezikohet dhe ulja e punës së sektorit të ndërtimtarisë që përfshin 10 për qind të të punësuarve në shtet, si dhe kontribuon me 10 për qind në Prodhimin e Brendshëm Bruto, ndërsa ndikon në mënyrë indirekte edhe në më shumë se 26 degë të tjera. Sipas Ivica Jaqimovski, kryetar i Odës së Ndërtimtarisë pranë Lidhjes së Odave Ekonomike, kompanitë po ballafaqohen me probleme serioze administrative gjatë lë-

shimit të lejeve për ndërtim, të cilat në vend që për tre javë, dinë të vonohen edhe deri në 100 ditë.

Gjithashtu, të dhënat statistiko-re tregojnë se në mars të vitit 2017 janë lëshuar 211 leje për ndërtim, prej të cilave 119 për ndërtime të larta, 35 leje për objekte me ndërtime të ulëta dhe 57 për objekte që do të rikonstruohen, apo 45 për qind më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. "Nevojitet të tejkalohen obstrukcionet e komunave lidhur me lëshimin e lejeve ndërtimore. Gjithashtu, mos respektimi i afatave ligjore prej 20 ditë nënkupton prolongimin e procesit të ndërtimit, që sjell edhe harxhime shtesë për kompanitë dhe qytetarët. Nevojitet të vendoset një dinamikë sipas së cilës, do të dihet saktësisht investimi i siguar, dinamika e realizi-

mit, mënyra e pagesës...", thotë Jaqimovski.

Nga ana tjetër, zëvendëskryetar i Odës së Ndërtimtarisë, Zoran Azmanov, thotë se në rast se shpejt nuk miratohet prolongimi i pagesës së 5 në vend të 18 për qind të TVSH-së për blerjen e banesës së parë deri në vitin 2023, rrezikohet edhe Prodhimi i Brendshëm Bruto, si dhe të ardhurat në buxhet nga ndërtimtarët. "Nëse sa më shpejt nuk zyrtarizohet afati kohor për këtë masë, do të kemi ulje të të ardhurave në buxhetin e shtetit në bazë të kontributeve dhe tatimit personal si rrjedhojë e uljes së punësimit në këtë sektor, pastaj do të kemi edhe ulje të të ardhurave në buxhet në bazë të TVSH-së që realizohet nga shitja e materialeve ndërtimore dhe pajisjeve tjera që vendosen në ba-

nesat e reja, ulje të tatimit në fitim për shkak të stagnimit të tregut të patundshmërisë... Gjithashtu, edhe çështja banesore e të rinjve më vështirë do të zgjidhet, ata do të ikin jashtë, ndërsa një pjesë e të hollave do të derdhet jashtë shtetit", thotë Azmanov. Sipas tij, afaristët e sektorit të ndërtimtarisë nevojitet që sa më parë të kenë një pasqyrë të pastër lidhur me aspektet e ndryshme të ndërtimtarisë, duke filluar nga zgjatja e afatit të pagesës së 5 në vend të 18 për qind të TVSH-së për banesën e parë për shkak se ndërtimtarët paraqet një proces që planifikohet në mënyrë afatgjate dhe jo sot për nesër.

"Nevojitet që menjëherë të zgjidhet çështja e lartpërmendur për shkak se kjo nënkupton se ndërtimtarët deri në fund të vitit 2018 nuk mund të planifikojnë investime të reja për vitin 2019, pasi biznesi nuk do të ketë mundësi që sigurt të blejë lokacione të reja për ndërtim dhe të planifikojë ndërtimin e banesave të reja", thekson Azmanov. Ai njëherësh ka kërkuar që një vëmendje më të madhe ti kushtohet edhe ndryshimit eventual të Planeve të Detajuara Urbanistike, të cilat nuk duhet të jenë pengesë për realizimin e investimeve në sektorin e ndërtimtarisë.

Ndryshe, ndërtimtarët vitet e kaluara së bashku me konsumin e qytetarëve dhe eksportet e realizuara nga kompanitë e huaja në Zonat e lira industriale, ishin ndër mbështetësit kryesor të rritjes ekonomike në Maqedoni.

RAPORT PËR LIRINË E SHPREHJES

Qeveria është ende shumë larg nga përbushja e reformave urgjente prioritare në media. Pavarësisht ndryshimeve në disa sfera, aksesit i gazetarëve tek informacionet është i komplikuar, televizioni shtetëror mban të njëjtën skemë programore, mungon transparenca nga institucionet pas ndërprerjes së reklamimit, ndërsa sa i takon ndryshimeve në Ligjin për shpifjen dhe ofendimin, nuk është marrë asnjë iniciativë konkrete

Reforma mediale në gjysmë të rrugës

Koha Evis HALILI

Shkup, 23 maj - Reformat urgjente prioritare që do të duhej të ndërmerreshin në sferën e mediave nga ana e Qeverisë, janë në hapat e parë. Në raportin e përpiluar nga tre asociacione "Metamorfozis", "Agora" dhe "Pina" janë marrë në analizë puna e institucioneve gjatë tre muajve të parë të këtij viti dhe konstatimi i përgjithshëm është se reformat kanë nisur pjesërisht në vetëm tre nga katër shtyllat ku do të duhet të zhvillohet procesi reformues, në servis publik të radiodifuzionit, tek reklamat e qeverisë dhe aksesit tek informacioni, ndërsa shpifja dhe ofendimi është një prej pikave në të cilën nuk ka asnjë progres. Pavarësisht se gjatë vitit të kaluar është reduktuar numri i padive dhe i kontesteve gjyqësore kundër gazetarëve për shpifje dhe ofendim, nuk ka asnjë ndryshim apo ndonjë lëvizje në periudhën e mo-

nitorimit dhe raportimit. Vendimet gjyqësore interpretohen në formë të ndryshme, ndërsa dilemat në gjykata nëse mediat online duhet të konsiderohen si media dhe të të punësuarit në to si gazetarë apo jo. Praktika gjyqësore tregon se ka interpretim arbitrar për këto subjekte dhe për gazetarët që punojnë në këtë lloj medimesh. Po ashtu, nuk është ndërmarrë asnjë iniciativë për ndryshimin e Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifjen dhe ofendimin dhe të rregullave procedurale me qëllim që të harmonizohen me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Qeveria nuk ka filluar koordinim me ekspertët në këtë drejtim. Sa i takon reformave të premtuara nga Qeveria për akses tek informacionet, raporti vëren se janë pjesërisht të realizuara.

"Edhe pas masave të marra për akses të gazetarëve tek bazat publike të të dhënave, disa ministri mundësuan aksesin online për pu-

blikun më të gjerë, lidhur me të dhënat për shpenzimet, marrëveshjet për tenderët, furnizimet, e të tjera. por mbetet e pandryshuar gjendja tek Ligji për akses tek informacionet me karakter publik. Ende nuk janë formuar grupet e punës në Ministrinë e Drejtësisë dhe as që ka filluar ndonjë lloj aktiviteti në këtë drejtim", thuhet në raport.

Sipas hartuesve të tij, edhe aksesit i gazetarëve për marrjen e informacioneve në institucionet shtetërore është i pamundur në shumë raste. Lidhur me shtyllën "reklamimi qeveritar", raporti vëren se edhe pse Qeveria nuk reklamonte me në media, ajo nuk ka dhënë sqarime të detajuara për një sërë aspektesh të veçanta për të siguruar transparençë të plotë dhe llogaridhënie, duke publikuar rregullore, procedura apo protokolle. Përveç kësaj, në nenin 102 të Propozim-ligjit për shërbime audio dhe audio-vizuale media-

tike, është lënë mundësia për reklama të institucioneve qeveritare dhe ndërmarrjeve të tjera publike. Servisi publik radiodifuziv është hallka e katërt e procesit reformator, në të cilin reformat nuk kanë dhënë asnjë rezultat.

"Ndryshimet e filluara në legjislacionin e mediave nuk mundën të përfundojnë në Parlament dhe ato ligjore ende nuk janë miratuar nga Parlamenti. Shërbimet programore të televizionit janë në formatin e njëjtë edhe përkundër obligimit ligjor për hapjen e kanalit të katërt televiziv. Nuk është regjistruar asnjë hap reformues për ta përmirësuar punën dhe cilësinë e përbajtjes së programit/ofertës në transmetuesin publik", konstatohet në raportin e tre asociacioneve.

Raporti është realizuar në kuadër të projektit "Observatori për reforma mediatike", dhe është mbështetur nga fondacioni Shoqëri e hapur.

KATËR VITE NË PRITJE TË PROJEKTIT

TREGU I SHUMICËS ENDE JOFUNKSIONAL

"Në këtë treg ishte destinuar të bëhet shitja me shumicë, ndërsa kapaciteti ishte paraparë për 40 automjete më të mëdha. Hapësira është rreth 3000 metra katrorë, e cila ende nuk është funksionale shkaku se nuk ka të interesuar", thonë nga NPK-ja e Tetovës



treg nuk po gjen mënyrën për të qenë një treg për ata që dëshirojnë që të shesin me shumicë prodhimet e tyre. Edhe pse kanë kaluar katër vite, megjithatë i njëjti nuk përdoret nga shitësit. Në rrugët e Tetovës gjithandaj vërehen shitës në trotuare, kurse më shumë i vëren përgjatë rrugës për tek Qendra sportive, të cilët me kamion dhe traktorë uzurpojnë hapësirat publike.

Edhe pse disa herë të njëjtit gjobiten nga ana e policisë, megjithatë sërish ata qëndrojnë në atë vend edhe pse tregu ekziston afër aty. Kryesisht këta shitës

qëndrojnë në rrugën për tek Qendra sportive dhe në bulevardin "Blagoja Toska", po kohëve të fundit vërehen edhe në bulevardin e Ilindenit.

"Fillimisht ishin rezervuar vetëm 15 vende për shitje. Por edhe ato nuk filluan asnjëherë, duke parë mos interesimin e tjerëve. Në këtë treg ishte destinuar të bëhet shitja me shumicë, ndërsa kapaciteti ishte paraparë për 40 automjete më të mëdha. Hapësira është rreth 3000 metra katrorë, e cila ende nuk është funksionale shkaku se nuk ka të interesuar", thonë nga NPK-ja e Tetovës. Nga

kjo ndërmarrje bëjnë të ditur se në këtë periudhë, gjithnjë më shumë ka shitës të tillë të cilët nuk shfrytëzojnë tregun.

Tash katër vite që nga iniciimi i rregullimit të tregut me shumicë, megjithatë kjo iniciativë e ndërmarrjes dështoi ose thënë ndryshe nuk funksionoi për arsye se tregtarët, shitësit ambulant nuk shprehën gatishmëri që veprimtarinë e tyre tregtare ta kryejnë në këtë hapësirë edhe përkundër një shumë simbolike prej 100 denarësh në ditë - shumë kjo që tregtarët duhej të paguanin për të zhvilluar veprimtarinë e tyre tregtare. Pas

disa vitesh, Ndërmarrja Publike Komunale Tetova - Tetovë ju bëri një ofertë tjetër shitësve ambulant për tu futur në hapësirat e tregut të gjelbër, ku 6 muaj pa pagesë do të mund të kryenin veprimtarinë e tyre tregtare, megjithatë as kësaj oferte të ndërmarrjes shitësit ambulant nuk iu përgjigjën pozitivisht dhe vazhdojnë të shesin produktet e tyre në hapësira publike, si në trotuare përfeth tregut të gjelbër, thonë nga ndërmarrja publike komunale e Tetovës.

Krahas kësaj, policia disa herë i ka larguar shitësit ambulant përreth tregut, por edhe ata nuk kanë vende adekuate dhe të përshtatshme, prandaj edhe disa herë kanë shprehur revoltën e tyre për një mungesë të vendit adekuat, ku ata do të mund të shitnin prodhimet e tyre, sidomos bujqit tetovarë.

Nga policia e Tetovës theksuan se ndaj këtyre personave shpeshherë është janë shqiptuar dënime, por të njëjtit vijojnë të ushtrorjnë veprimtarinë e tyre në trotuare. Bëhet e ditur se gjobot ndaj këtyre shitësve arrijnë deri në 300 euro. Ndryshe, ideja për një treg për shitje me shumicë në Tetovë, sipas drejtuesve të NPK-së, ishte se deri më tash - prodhimet e ndryshme me shumicë janë shitur nëpër trotuare dhe kanë penguar edhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 maj - Në fillim të vitit 2014, në Tetovë u rregullua një hapësirë për treg të ri. Pikërisht afër stacionit të autobusëve dhe stacionit hekurudhor në qytetin e Tetovës. Por që atëherë e këndej kjo pjesë nuk është vënë në funksion për qëllimin që kishte. Ka ngelur ende kjo hapësirë që nuk shfrytëzohet dhe nuk është rregulluar për atë destinim që ishte rregulluar para katër vitesh. Sot e kësaj dite, ky vend i destinuar për

Qendra për traumatizëm sportiv hapet në "8 Shtatori"



Shkup, 23 maj - Lëndimet posttraumatike të sportistëve profesionistë dhe atyre që merren me sport rekreativ do të trajtohen në Qendrën për traumatizëm sportiv i cili u hap sot në Repartin për Ortopedi dhe Traumatologji pranë Spitalit të Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori" në Shkup. Në hapjen e Qendrës mori pjesë edhe ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, i cili tha do të ketë sistem për caktimin e terminëve për pacientë kronikë, por edhe pacientë urgjentë të cilët përmes Qendrës së Urgjencës do të dërgohen në SPQ "8 Shtatori". "Këtu tashmë pu-

nojnë ekspertë të shquar traumatologë dhe ortopedë të cilët merren me këtë patologji", theksoi Filipçe dhe shtoi se me atë që pajisin një repart të posaçëm tregon seriozitetin me të cilin i qasen trajtimit të të lënduarve", theksoi Filipçe. Drejtori i spitalit, Kristian Kosotov deklaroi se në Qendrën e cila është e para e këtij lloji në vend dhe rajon të lënduarit të fitojnë procedurë primare dhe të shpejtë diagnostifikuese, kontroll ortopedik-traumatologjik, analizë laboratorike dhe të llojlojshme radiologjike siç janë tomografia, rezonanca magnetike... (D.K)

Fetai me bashkëshorten shpallen "Ambasadorë të Paqes"

Tiranë, 23 maj - Profesor Milaim Fetai dhe bashkëshortja e tij Ajla Fetai, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Familjes u nderuan me titullin "Ambasadorë të Paqes". Ky çmim ju dha nga Federata e Paqes Universale në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar në Tiranë, ndërsa krahas tyre, çmimin e morën dhe disa personalitete të artit dhe jetës publik, mes të cilëve autori i njohur Bujar Asqeriu dhe zonja Eni Çobani. Pjesë e rëndësishme e aktivitetit ishte edhe performanca artistike e shkollës së fëmijëve me probleme në të pamurit.

Në fjalën përshëndetëse pas marrjes së çmimit, profesor Fetai tha se "shoqëria post-moderne, duket sikur ka shtuar sfidat për njerëzimin! Ata që trajtojnë këto sfida, tentojnë për zgjidhje në media, por duket se kanë lënë mënjanë disa zgjidhje të vogla që mund të jenë çelësi i zgjidhjes, në mos zgjidhja vet".

"Unë po përmend dy nga këto zgjidhje të vogla që i gjej të dyja



në filozofinë e Federatës së Familjes. Njëra është pikërisht ruajtja e familjes.

Sigurisht ruajtja e bërthamës së familjes, por edhe aspekti vertikal i saj. Pra, dashuria të mos ndalojë tek prindërit, por të shkojë edhe për gjyshërit, edhe për hallën, edhe për tezen, apo dajën. Së dyti, edukimi që e çon motivin e jetës nga shpirtërorja dhe e braktis materialen! Të dyja këto baza mua më bëjnë që të

pranoj e të ndihem i nderuar për titullin e Ambasadorit të Paqes! Faleminderit propozuesit, zotin Memia dhe faleminderit edhe atyre që pranuan këtë propozim", tha në fjalimin e tij, profesor Fetai.

Është hera e dytë që profesor Fetai vlerësohet me çmim në Shqipëri, pas çmimit të "Imazhit Kombëtar" pak kohë më parë, për shkak të kontributit qytetar, shoqëror dhe intelektual të tij.

Gjuha për shpresë

Nga

Nazim RASHIDI



Maqedonia po kalon një prej periudhave më të rëndësishme dhe sa do që këtë fjali e kemi dëgjuar shumë, sërish e tillë është edhe situata aktuale. Jam plotësisht i vetëdijshëm se sa shumë u përdor para zgjedhjeve parlamentare, para krijimit të shumicës së re qeverisë, sa shpesh u përdor kur u votua kryetari i parlamentit, si u përdor kur u evitua përplasia e re etnike, sa herë përdorej para ikjes së Gruevskit, e sa herë pa fund është përdorur vetëm në periudhën e mbamendjes tonë kolektive që nga pavarësia e deri më tani.

Por sërish, po kalojmë një periudhë të rëndësishme e delikate e cila nuk është e qartë se në çfarë mënyre do të kanalizojë zhgënjimet, nëse lihet përshtypja se nuk do të ketë shumë shpresë për përparim.

Një shprehje thotë, "mos qofsh i mallkuar e të jetosh në kohë interesante". Dhe për fat të keq e tillë duket gjendja. Interesante deri në kulm, ku as e si të ndalojë ankthi dhe të kthehemi në vende ku fokus do të jetë normaliteti. I qartë jam se ne nuk do të bëhemi Norvegji menjëherë, por sërish do të ishte mirë mbase disa vite mos të kemi drama të mëdha shoqërore.

Por, ky është realiteti ynë dhe nuk mbetet tjetër veç se t'i bëjmë ballë, ashtu siç edhe ka ndodhur edhe në të kaluarën. Fillimisht të shohim propozimin e ri që do të duhej të zgjidhte mosmarrëveshjen me Greqinë, propozim aq shumë i pritur ku edhe më skeptikët, fshehurazi shpresonin se kjo çështje do përfundojë.

"Republika Maqedonia e Ilindenit" (Atë përkthimin tjetër nuk e përdor dot por do t'i kthehem dhe atij më vonë në tekst) duket një propozim që realisht mund të sjellë përparim në mbylljen e mosmarrëveshjes sepse është sqaruar më se përmban kërkesat greke duke bërë dhe një dallim nga antikiteti, që ishte një nga shqetësimet kryesore të Athinës.

Por pse refuzimi? Në fakt nuk ka as edhe rëndësi pse. Tashmë Maqedonisë i duhen miqtë e komunitetit ndërkombëtar që realisht të ndihmojnë procesin, të cilin Kryeministri Zaev e mori përsipër ta çojë deri në pikën që askush se kishte bërë deri më tani.

Nga përvoja, ngjarjet e tilla nuk është se nuk sjellin lëvizje të theksuara diplomatike, këtë mund ta vini re edhe në deklarata sa do "të thata" në dukje të zyrave të rëndësishme

globale, por kjo më duhet të tejkalojë të paktën sa i përket interesit të thjeshtë të njerëzve, kortsia dhe reagimi e ndihma ndërkombëtare të jetë e konsiderueshme dhe të rezultojë me sukses.

Maqedonia nuk mbijeton dot përplasjen e titanëve politikë globalë nëse mbetet e vetme. E qartë është se gara gjeopolitike do të bëhet për çdo centimetër ndikim, por pas kaq përpjekje të madhe nuk mund të lihen njerëzit me shpresën në Maqedoni, sepse ata vetë do të nisen në Evropë. Dy milionë njerëz mund të mos jenë të rëndësishëm në fate globale, por individualisht secili prej tyre pret pak realizim të kësaj shprese.

Miqtë ndërkombëtarë nuk ka se si mos ia shpjegojnë këtë Greqisë. Dhe në fakt e gjithë situata tani po mbetet të shihet tek roli ndërkombëtar. Në të kundërt Maqedonia, e cila edhe ashtu është shpesh në erëra ndikimesh të ndryshme, do të gjenet në një furtunë implikimesh ku rusët, apo dhe ndikimet e tjera nga lindja do të jenë gati që të shfaqin më hapur interesat e tyre.

Në të kaluarën kishte koketime me këto ndikime, aktualisht ka një shkëputje të qartë duke bërë të prera aspiratat për integrimet në NATO

dhe BE, por çështja është se askush nuk e di se çfarë efekti mund të sjellë një moszgjidhje e mundshme e çështjes së emrit. E ngritur aq shumë dhe duke qenë se ishte në fokus dhe gjithnjë me mesazhin se emri edhe mund të zgjidhet zhgënjimi mund të sjellë edhe pllakosje që veç se nxitjes masive për ikje, që edhe ashtu është duke ndodhur, mund të sjellë edhe implikime të tjera.

Këto konstatime nuk është se duhen marrë si formë kërcënimi, por thjeshtë si një proces reagimi aksion-reagion, ku disa herë ligjet emocionale thjeshtë mund të prodhojnë edhe lëvizje të pa parashikuara dhe padëshiruara.

Një gjë e tillë nga ana tjetër do të vinte në një udhëkryq ters shqiptarët. Ata të tjerët në rajon janë qartë të përcaktuar drejtë Perëndimit, kjo mund të shkaktoje lëkundje brenda shqiptarëve si dhe në Maqedoni ashtu edhe mes shqiptarëve në rajon. Prandaj jo rastësisht roli ndërkombëtar duhet përforcuar në momentin e krijuar për çështjen që sado që dukej se ishte në prag të zgjidhjes, sërish po shfaqet si komplekse. Por tashmë kompleksiteti për shumë po krijohet nga Greqia. Pranimi i "erga omnes" dhe theksimi i një karakteri shumë

Por duke marrë simbolikën e lëvizjes së fjalëve dhe akrobacirat me përkthimin pa nevojë të fjalës "Ilinden", të gjitha këto pra rrotullime fjalësh dhe akrobacira tashmë duhet të ndodhin në holle zyrash ndërkombëtare të partnerëve të mëdhenj e të rëndësishëm...



etnik i Maqedonisë është momenti unik që miqtë e saj me ndikim, do të duhet ta vlerësojnë dhe të ndihmojnë në gjetjen e zgjidhjes, që kësaj herë më shumë mund të vijë nga Greqia. Jam i bindur se po nuk zgjidhet emri shumë variante do të shfaqen për forma alternative anëtarësimi të Maqedonisë në institucionet ndërkombëtare, por të gjitha ato nuk do të jenë pjesë e synimit aktual që është interes edhe i Maqedonisë edhe shqiptarëve, anëtarësimi i plotë një herë në NATO e pastaj dhe në BE.

Si rrjedhojë, (dhe po i kthehem përkthimit të emrit Ilinden), s'është kohë kompleksesh të reja si ai që u shfaq me përkthimin e fjalës "ilinden". Shqiptarët e maqedonasi me vite kanë jetuar bashkë dhe ia dinë festat njëri-tjetrit. Një moment historik si ai i 2 gushtit 1903, ka ndodhur që të ngjajë në një ditë feste si Ilindenit. Pikërisht si e tillë prandaj përdoret lirshëm nga shqiptarët. Kjo nuk është një ditë apo term prej dje dhe do përbënte habi në përdorje. Madje në fjalimet e kësaj feste ku zyrtarë shqiptarë kanë marrë pjesë ajo asnjëherë nuk është përkthyer. Ndërkohë sa i përket strukturës së saj, që është plotësisht jo shqiptare, gjuhëtarët e shpjeguan më së miri.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovska lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: Adria Media Balkan - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e mërkurë 23 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Ata që dinë gjuhët, cilët do qofshin (dhe po dite gjuhë e di se ca gjëra nuk përkthehen fjalë për fjalë) ato duhet t'i përdorin për të ushtruar ndikimin që çështja të mbyllet dhe shpresa e krijuar mos të shndërrohet në frikë



Atë që dua të theksoj është se nuk është moment relativizimi politik, por është një moment ku pa shqiptarët kjo çështje nuk zgjidhet, por kjo s'do me thënë se energjia duhet të harxhohet në çështje që nuk ekzistojnë apo dhe terma konfuz. Sa i përket emërimit politika duhet t'ia lë gjuhëtarëve rregullat se si do të përdoret, por sa i përket ndikimit ajo duhet të kanalizojë energjitë. Që të kuptohet sa gabime kishte në përkthim duhet përmendur fakti, se edhe nëse përdoret termi "Ilinditase" ai do jetë në fund të togfjalëshit që përshkruan shtetin. Sepse "Ilinditase" shpjegon Maqedoninë dhe jo "Republikën". Pra Republika s'është "Ilinditase", por Maqedonia. Prandaj emri dhe me këtë term do të ishte "Republika Maqedonia Ilinditase".

Por, duke marrë simbolikën e lëvizjes së fjalëve dhe akrobacirat me përkthimin pa nevojë të fjalës "Ilinden", të gjitha këto pra rrotullime fjalësh dhe akrobacira tashmë duhet të ndodhin në holle zyrash ndërkombëtare të partnerëve të mëdhenj e të rëndësishëm.

Ata që dinë gjuhët, cilët do qofshin (dhe po dite gjuhë e di se ca gjëra nuk përkthehen fjalë për fjalë) ato duhet t'i përdorin për të ushtruar ndikimin që çështja të mbyllet dhe shpresa e krijuar mos të shndërrohet në frikë.

Gjuha duhet përdorur për të ritheksuar shpresën e cila do të çojë në Perëndim edhe vendin edhe njerëzit bashkë. Në të kundërt do të mbesë një hallakatje, pa nevojë, mes Lindjes dhe Perëndimit, si ky diskutimi pa nevojë "Ilinden" apo "Ilinditase".

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Profesor Ethem Selimi, personalitet i kombit



Nga Osman KADRIU

Në moshën 86-vjeçare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 9 maj 2018 ndërroi jetë profesor Ethem Selimi nga fshati Sërbicë e Kërçovës. Varrimi i të ndjerit u bë në varrezat e vendlindjes, më datë 16.05.2018.

Profesor Ethem lindi në vitin 1932 në fshatin Sërbicë, në një familje punëtore, arsimdashëse, atdhetare dhe me vlera të larta morale. Pas kryerjes të shkollës së mesme – Normales, filloi me punë si mësues në shumë shkolla tetëvjeçare në rrethinën e Kërçovës. Gjatë ushtrimit të profesionit mësues, në ndërkohë mbaron edhe ciklin arsimor për mesimdhënës dhe pastaj fakultetin filologjik dhe e fiton gradën – profesor i gjuhës shqipe me letërsi.

Karrierën e punës e vazhdon dhe më gjatë do të ngel në shkollën tetëvjeçare "Skenderbeu" në fshatin Sërbicë deri në diferencimin e tij ideopolitik dhe përjashtimin nga procesi arsimor. Në procesin arsimor profesor Ethem do të ushtronte edhe detyrën drejtor i shkollës në më shumë mandate. Si profesor dhe si drejtor ka qenë i dalluar. Punëtor i përgatitur dhe me një disiplinë të theksuar. Ishte punëtor i palodhshëm, profesional, i përgjegjshëm dhe tejet i drejtë në procesin arsimor. Ishte privilegj për të gjitha gjeneratat që kanë mësuar dhe janë shkolluar në periudhën kur postin mesimdhënës dhe drejtor shkolle e ka ushtruar profesori. Nxënësit e profesorit nga ai dhe prej tij fituan edukatë cilësore dhe arsimim të përsosur me frymëzim atdhetarë.

Biografia e profesorit është shumë e përsosur, e pasur, e dendur dhe shumë dimensionale, me shumë aktivitete, veprime, vepra dhe kontribute në shumë lëmi. Në veçanti dallohet veprimtaria e profesor Ethemit në jetën politike dhe publike. Gjatë ushtrimit të profesionit profesor dhe drejtor i shkollës, profesor ushtronte detyra publike. Në disa mandate do të jetë këshilltar i Kuvendit komunal si dhe anëtarë në organet e organizatave shoqëro-politike të komunës. Në ushtrimin e detyrave të përmendura profesor ishte i flaktë për luftimin e të drejtave nacionale shqiptare dhe avancimin e statusit kushtetues, juridik dhe politik të shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë. Dhe më konkretisht, në vitet 70-ta të shekullit që lamë pas (Shekulli XX) edhe në Kërçovë fillon një betejë politike për avancimin e gjuhës shqipe, në veçanti për arsimimin në gjuhën shqipe dhe hapjen e shkollave të mesme. Kërkesa ishte e qartë. Hapja e gjimnazit dhe të drejtave tjera të

Veprat e tij kolosale e bëjnë të pavdekshëm. Me veprat e tij profesori ndërtoi një përmendore të përrjetshme të kulturës nacionale shqiptare dhe të cilat vepra bëjnë pjesë në historinë politike bashkëkohore të shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë

shkollimit të mesëm ishte prioritet. Pushteti i asaj kohe nuk kishte disponim politik që këto të drejta t'i pranon si realitet dhe si të tilla të realizohen në praktikë. Profesor Ethem kryesonte gati me të gjitha delegacionet, komisionet dhe grupet e ndryshme dhe në mënyrë institucionale t'i parashtron dhe artikulon kërkesat e natyrës nacionalo-shqiptare në organet e pushtetit vendor dhe atij republikan. Kjo në veçanti në organet e pushtetit si dhe në organet partiake. Në të gjitha takimet e radhës, seancat si dhe në mbledhjet e ndryshme para organeve të përmendura, profesori e kishte fjalën hyrëse dhe atë të fundit – përfundimtare rreth çështjes së gjuhës shqipe në arsimin e mesëm. Në vendimmarrje ishte i paluhatshtëm, këmbëngulës dhe guximtarë. Kërkesat e kësaj natyre gjithmonë i mbronin me fakte dhe argumente juridikisht të themelta. Cilësi e veçantë e profesorit ishte oratoria e theksuar. Nga aspekti i oratorisë dhe nga ky kriter profesor Ethem ishte Ciceroni shqiptarë.

Në të gjitha mbledhjet në të cilat në rend dite parashtruhej kërkesa e gjuhës shqipe dhe përdorimi i saj në shkollimin e mesëm, në ato mbledhje vërehej një tensionim i theksuar, me shumë vërejtje, urrejte, ofendime dhe kërcënime nga ana e pushtetit kundër të gjithë aktivistëve dhe veprimtarëve të njohur shqiptarë të cilët luftonin për çështjen dhe kauzën shqiptare. Në veçanti dhe me një arrogancë dhe injorim të tepruar veprimeve edhe ndaj profesor Ethemit.

Në bazë të shënimeve stenografike nënvizohet edhe një polemikë ndërmjet delegacionit me të cilin kryesonte profesor Ethem dhe përfaqësuesve të pushtetit. Profesor gjerë e gjatë e elaboroi kërkesën për hapjen e gjimnazit në gjuhën shqipe. Dy përfaqësues të pushtetit ashpër e kundërshtojnë diskutimin e profesorit. Ato njëzëri i thanë: "Shoku Ethem, këto të drejta që i kërkon, edhe sikurse të jenë me ligj, ne nuk ua japim. Nuk ka kushte

dhe nuk ka ardhur koha për ato." Profesori çohet në këmbë dhe u kundërpërgjigj me zë të lartë. Në atë çast i plasi turiri i buzëve të gojës dhe fillon ti rrjedh gjaku. Diskutimin profesori nuk e ndërpret dhe u përgjigjet: "Shikoni shokë, në qoftë se punohet për të drejta që ju duhet të na jepni, ne ato të drejta nuk i duam. Popullata shqiptare nuk ka nevojë për ato të drejta. Por mos harroni, për të drejtat të cilat i garanton ligji dhe kushtetuta e vendit, ne nuk do të heqim dorë nga ato të drejta. Ato të drejta do t'i kërkojmë dhe do të qëndrojmë deri në fund të këtyre kërkesave". Me këtë u mbyll mbledhja maratonike dhe tejet e tensionuar.

Për këto aktivitete, të harmonizuara dhe të koordinuara nga profesori si dhe puna tejet e lodhshme dhe e mundimshme i dhanë rezultatet e para. Ndodhi ajo që pritej. Në Kërçovë u hap gjimnazi në gjuhën shqipe. Gradualisht erdhi edhe të hapja e drejtiveve tjera të nivelit të arsimit të mesëm në gjuhën shqipe. Këto ndodhi ndodhën në periudhën kohore 1970 – 1975.

Në betejën politike për të drejtat e shqiptarëve në Kërçovë dhe më gjerë profesor Ethem ka qenë gjithmonë i rreshtuar në "eshalonin e parë", natyrisht, së bashku me veprimtarë dhe atdhetarë të shquar të kombit shqiptarë nga Kërçova. Veçohet bashkëpunimi i profesorit me veprimtarin e njohur mr. Abidin Zenku, poashtu nga fshati Sërbicë, si dhe me veteranin e njohur të arsimit shqip – mësuesin Baftir Rrushaj nga fshati Drogomisht i Vogël.

Me vetë rreshtimin në eshalonin e parë në betejat politike për të drejtat nacionale shqiptare, profesori ishte i vetëdijshëm edhe për rrezikun që mund t'i ndodhi nga pushteti. Kjo edhe i ndodhi. Së pari, profesori e flijoi shëndetin e tij në ushtrimin e aktiviteteve të përmendura. J'u keqësua gjendja shëndetësore, dhe kjo gjendje shëndetësore e dobët dhe e ligë do t'a përcjelli deri në ditët e fundit të jetës. E dyta, profesori nga pushteti përjashtohet nga partia dhe përjashtohet nga procesi arsimor. Kjo ndodhi në dridhjet e fundit politike dhe në "tërmetin politik" që ndodhi në Maqedoni dhe në Jugosllavi pas vitit 1980 dhe zgjati deri në vitin 1990 me shpartallimin e Jugosllavisë dhe shembjen e sistemit totalitar.

Për të siguruar kafshatën e bukës, pas përjashtimit nga procesi arsimor në periudhën e përmendur, profesor Ethem do të kalon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të siguruar kafshatën e bukës dhe atje do të ngel deri në ditët e fundit të

jetës. Në të njëjtën mënyrë është vepruar edhe me aktivistët dhe veprimtarët tjerë të kombit shqiptarë të cilët në preokupimin e tyre e kanë pasur kauzën shqiptare. Masat e shtetit kundër tyre ishin të njohura: e para, përjashtimi nga puna dhe partia; e dyta, për një numër të veprimtarëve u organizuan gjykime të montuara politike për vepra politike penale dhe u shqiptuan dënime drakonike me vuajtjen e dënimit me burg nëpër burgjet famëkeqe të Maqedonisë dhe jashtë saj duke përdorur ndaj personave të burgosur masa çnjerëzore, poshtëruese, ofenduese dhe degraduese; dhe së treti, mjerisht një numër i veprimtarëve përfunduan me likuidim – ekzekutim nga ana e shtetit dhe shërbimeve sekrete të tij. Të gjitha këto ndodhi më së miri dhe me prova materiale u vërtetuan nga ligdhënësi me miratimi e Ligjit për përndjekjen e personave për çështje ideologjike dhe politike të përgatitur nga organet e shtetit. Ligji u miratua në vitin 2000. Konform Ligjit në fjalë edhe profesor Ethem ishte i "pajisur" me Dosje mirë e përgatitur nga shërbimet shtetërore. Edhe tash Dosja e profesorit gjendet në familjen e tij. Në bazë të dosjeve u konstatua se në Republikën e Maqedonisë ka pas të përndjekur mbi 24000 qytetarë. Prej këtij numri 80% janë shqiptarë.

Edhe përkundër sakrificave dhe pasojave që pati profesori, ai vazhdoi me aktivitetet e tij publike dhe politike në sistemin shumëpartiak. Në vitet 1990 anëtarësohet në parti politike shqiptare. Me kalimin e tij në SHBA vazhdon me detyra konkrete dhe organizata politike dhe jo-qeveritare dhe në veçanti ka bashkëpunuar me Lobin shqiptaro-amerikan. Në brendinë e të gjitha aktiviteteve, profesori Ethem përsëri e kishte preokupimin e tij për çështjen e shqiptarëve dhe për statusin e shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë. Me të gjitha veprat dhe veprimet e profesorit të ushtruara në jetën politike dhe publike rrumbullakësohet dhe rrethkohet personaliteti i tij. Me këtë profesori Ethem e fiton statusin të një personaliteti të kombit, personaliteti i kohës. Ai vetëm fizikisht ndahet nga kjo botë. Veprat e tij kolosale e bëjnë të pavdekshëm. Me veprat e tij profesori ndërtoi një përmendore të përrjetshme të kulturës nacionale shqiptare dhe të cilat vepra bëjnë pjesë në historinë politike bashkëkohore të shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë.

(Autori është anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë, si dhe ish-nxënësi i profesorit Ethem)

"Ambalazha" dhe përmbajtja e "Ilindenit"



Nga
Daut DAUTI

Nëse shkruan për një temë me vonesë, pasi të kenë shkruar të tjerët, në rastin konkret në temën e Maqedonisë së Ilindenit, pasi kaluan disa ditë duke e prituri rendin, mund të mos i ofrosh asgjë të re lexuesit. Shumë shkronja kanë zënë vend furishëm para këtij teksti në gazeta e portale dhe hendikepi i tij tash mund të jenë mungesa e originalitetit, sepse "pas të vjelave", çdo autor e ka vështirë të thotë diçka të re që s'ka kanë thënë të tjerët. Nga ana tjetër, po të shikosh gjërat nga një këndvështrim konformist, është gjene "përparësi", sepse pasi u bë top-temë pas Samitit të Sofjes, mund ta kesh matur pulsën ("çka thotë populli") dhe kjo është mënyra më e mirë për t'u rreshtuar drejt dhe ta kthesh gëzofin "nga frynë era".

Nga një rezimë e debatit (kur çdo kush që di të përdorë shkronjat e merr të drejtën të japë mendim ekspertit), mund të nxirren disa konkluzione: Maqedonasit e përfaqësuar në qeveri janë PËR emrin Republika e Maqedonisë së Ilindenit, VMRO-ja taktizon, njësoj bën edhe kryetari Gjorge Ivanov, shqiptarët e përfaqësuar në qeveri e kanë përklarur, ndërkaq të gjithë të tjerët i kanë gjetur mangësitë, çka gjuhësore, çka politike. Ndërsa pala e dytë, grekët, ndonëse nga prezantimi i Zaevit dukej sikur janë pajtuar me të, e hodhën poshtë! Ndoshta dhe më mirë, për hir të një zgjidhjeje më të logjikshme.

KUPTIMI I "...ILINDENIT" "SI DITËLINDJE E SHTETËSISË"

Kur gazeta "Koha" e prezantoi e para nga burimet diplomatike propozimin REPUBLIKA E MAQEDONISË SË ILINDENIT, befasia e parë kishte të bëjë me përcaktuesin. Përdërisa deri tash në lojë ishin disa variante emrash me përcaktues gjeografik (E Epër, Veriore, e Varadarit, (Shkupi)...) dhe vetëm një me përcaktues kohor (E RE), propozimi që doli nga Sofja ishte padyshim me përcaktues KOHOR, që ngërthente në vete edhe aspektin historik (vetë konteksti kohor e bën historik), dhe vijën kufitare identitare shtetërore, e së këndejmi edhe vijën kufitare të identitetit kombëtar.

Pra, përcaktuesi "e Ilindenit" në mënyrë strikte Maqedoninë e definon si një entitet shtetëror që ka lindur në Ditën e Ilindenit, gjegjësisht, në aspektin historik, e lidh me Kryengritjen e Ilindenit në vitin 1903, prej së cilës doli edhe Republika e Krushevës që zgjati vetëm dhjetë ditë. Emërtimi i shtetit si Republikë e Maqedonisë së Ilindenit etimologjikisht bazat e veta i kërkon

Identifikimi i shqiptarëve me një Maqedoni të para 115 vjetëve (të Republikës së Krushevës si një referencë historike) është ajo pjesë në të cilën mund ta kërkojnë pozicionin e tyre madje më fortë se në kornizat e tashme kushtetuese-juridike. Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1946, e kishte bërë pikërisht reduktimin e idealit të Kryengritjes së Ilindenit dhe Republikës së Krushevës me uljen e statusit të shqiptarëve në nivelin e pakicës, që do të korrigjohet pjesërisht me kushtetutën e vitit 1974 (kombësi), do të ulet prapë më 1991 dhe do të rikthehet dukshëm me Marrëveshjen e Ohrit 2001

jo më larg se para 115 vjetësh, në formën e parë të shtetësisë së Maqedonisë.

Konotacioni fetar i emrit, vjen nga vetë ngjarja, pasi kryengritja ka ndodhur në një ditë fetare ortodokse (të cilën mund ta respektojnë ortodoksët maqedonas, bullgarë, grekë, serbë, shqiptarë...) dhe nëse nuk shikohen kontekstet tjera (politike, etnike...), ajo është një DITËLINDJE të cilës nuk mund t'ia ndryshosh datën, ajo ka ndodhur atë ditë kur ka ndodhur dhe nuk mund ta ndryshojmë. Pra, nga ky këndvështrim, lidhja e emrit të shtetit me një datë të këtillë, ka kuptimin historik prej kur daton shtetësia e Maqedonisë. Kontestuese për publikun shqiptar, siç është parë këto ditë, është konotacioni fetar ortodoks i ditëlindjes së shtetit (edhe Mbledhja e dytë e ASNOMI-it është mbajtur po më 2 gusht, ndaj dhe e quajnë ndryshe ILINDENI I DYTË), sepse në kontekstin e identifikimit në Maqedoni, ajo datë KRYESISHT lidhet me një popull (maqedonas) duke pasur karakterin etnik të kishave ortodokse gjithandëj rruzullit) me të cilën nuk mund të identifikohet pjesa myslimane që mund të jenë te 40 përqind (shqiptarë, turq, boshnjakë, torbeshë...). Prandaj dhe emri i shtetit që si atribut e ka ditëlindjen e vet në një datë fetare ortodokse, duket problematik, gjegjësisht, i identifikueshëm vetëm me maqedonasit ortodoksë. Nëse palët kanë ardhur gjer në këtë pikë, atëherë hapi më i logjikshëm ka qenë që emri i shtetit të propozohet me atë që nuk është DITLINDJE, por THELBI i krijimit të shtetit. Pra, nëse në kryengritjen e Ilindenit ka lindur forma e parë e shtetësisë dhe ajo ka mbajtur emrin Republika e Krushevës, kjo duket të jetë emri më adekuat, pra, Republika e Maqedonisë së Krushevës, ose modifikacioni Republika e Krushevës e Maqedonisë ose madje Maqedonia e Republikës së Krushevës. Më këtë pikë shqiptarët do ta ndjenin veten si pjesë konstituive të shtetit, ndonëse këtë gjë ua mundëson edhe "e Ilindenit" sepse republika e Krushevës lindi nga kryengritja që ndodhi në Ditën e Ilindenit.

KËNDVËSHTRIMET SHQIPTARË, GREKË, MAQEDONASE, BULLGARE, NDËRKOMBËTARE

Duke supozuar se ky emër do të dalë si propozim i ndërmjetësit Nimic edhe zyrtarisht, ta shikojmë aspektin e (pa)pranueshmërisë së tij kundrejt palëve të interesuara.

Para se të prononcohen grekët, u përshëndet nga Sofja zyrtare, sepse Maqedonia e Ilindenit identifikohet me "historinë e përbashkët" të dy popujve. (Edhe pse shtypi pro qeveritar i Maqedonisë e priti me ngazëllim si meritë e Zaevit, kumbara mund të jetë ulur në Sofje!). Bullgaria pas marrëveshjes me Maqedoninë për marrëdhënie fqinjësore, gjithnjë e më shumë shpreh pretendimet e veta për historinë e popullit maqedonas, ose bëhet tutor i shtetit të tij.

Ndonëse ky emër më shumë do t'u shkonte interesave të Greqisë, kryeministri grek Cipras e hodhi poshtë i pari! Kështu e la të hapur nëse në Sofje ishte marrë vesh me Zaevin për këtë emër, edhe pse ky i dyti la përshtypje se kjo ishte një ujdë e përbashkët. Do të ishte e palogjikshme që pikërisht Greqia ta hedhë poshtë këtë emër, kur duket ashiqare se ky emër e këput "kontinuitetin" që e kërkonte qeveria e Gruevskit me projektin Shkupi 2014 për identitetin antik, të cilin gjithë kohën e konteston Athina. Refuzimi grek do të thoshte se ky shtet vetëm shtret sa u përket negociatave, sepse qëllimi është që të pengojë me çdo kusht Maqedoninë për EU dhe NATO edhe pse me Marrëveshjen e Përkohshme të vitit 1995 nuk ka të drejtë ta bëjë (gjë që e vërtetoi me vendim e vet dhe Gjykata e Hagës). Mospranimi nga pala greke do të ishte edhe një dëshmi në sytë e OKB-së se pala që nuk do zgjidhje është Greqia. Por, refuzimi i tij është i mirë nga këndvështrimi shqiptar dhe në dobi të procesit, për të gjetur një emër më pak konfuz se ky, si bie fjala Maqedonia e Re, të cilin e parapëlqen ish ministri i jashtëm, Denko Malevski.

Për palën shqiptare, nëse e lëmë anësh aspektin fetar të atributit pranë emrit të Maqedonisë, gjithçka tjetër është në favor! Pse?

Sepse, Kryengritja e Ilindenit është një ngjarje historike që sublimon idenë për shtet të vetin të popujve që kanë jetuar, por jo për shtet dosido, por në baza të barazisë së plotë që sot mëtojnë ta ndërtojnë shqiptarët! Duket paradoksale, por ashtu është. Të shikojmë me radhë. E para, në atë kryengritje maqedonase-vllehe, organizatorët e kryengritjes kanë dalë me Proklamata drejtuar të gjithë popujve për t'iu bashkëngjitur me qëllim të çlirimit nga Perandoria Osmane, pra edhe shqiptarëve e turqve. E dyta, vetë Republika e Krushevës që lindi nga kjo kryengritje, e dha shembullin më të mirë se si është menduar shteti i ri. Organet e Republikës së Krushevës jetëshkurtër, ishin konstituuar në parimin e paritetit etnik: "qeveria" përbëhej nga dy maqedonas, dy vllehë dhe dy shqiptarë dhe "Kuvendi" 60 anëtarësh nga 20 përfaqësues nga këta popuj, me çka kemi shembullin më të mirë të një shteti ku në themel është vënë barazia e plotë e popujve që kanë jetuar me shumicë. Pra, identifikimi i shqiptarëve me një Maqedoni të para 115 vjetëve (të Republikës së Krushevës si një referencë historike) është ajo pjesë në të cilën mund ta kërkojnë pozicionin e tyre madje më fortë se në kornizat e tashme kushtetuese-juridike. Kushtetuta e Maqedonisë e vitit 1946, e kishte bërë pikërisht reduktimin e idealit të Kryengritjes së Ilindenit dhe Republikës së Krushevës me uljen e statusit të shqiptarëve në nivelin e pakicës, që do të korrigjohet pjesërisht me kushtetutën e vitit 1974 (kombësi), do të ulet prapë më 1991 dhe do të rikthehet dukshëm me Marrëveshjen e Ohrit 2001. Historia shqiptare nuk është marrë shumë me Kryengritjen e Ilindenit. Ka pasur disa polemika midis vetë historianëve shqiptarë lidhur me pjesëmarrjen e shqiptarëve në të. Disa minimizonin pjesëmarrjen në përmasa individuale, dhe të tjerët afirmonin modelin e barazisë në Republikën e Krushevës, si bërthamë e shtetësisë së Maqedonisë, duke kërkuar modelin më të përshtatshëm për ditët e sodit. Nëse shikohet ajo kryengritje nga këndvështrimi i idealit për të pasur shtet

kombëtar, atëherë pjesëmarrja e shqiptarëve në të duhet të jetë cenim i idealit. Nëse gjërat shikohen nga një këndvështrim i bashkëpunimit të popujve për një qëllim të përbashkët, ndihmesa e ndërsjellë midis tyre në lëvizje të mëdha është i natyrshëm. Prandaj dhe kur shqiptarët sot nuk janë atje ku duhej të ishin sipas synimeve shekullore, dhe jetojnë në një shtet që nuk quhet Shqipëri, atëherë duhet të gjenden format përkatëse të komunikimit dhe bashkëpunimit për një shtet funksional. Republika e Krushevës duket ai model që është dukur më i mundshëm dhe më funksional në atë kohë, dhe çka është më me rëndësi, ajo ka qenë ofertë maqedonase-vllehe për bashkëjetesë edhe për fqinjët tjerë në këto hapësira.

Nga atmosfera e krijuar rreth këtij emri, gjëja më e mirë është që Greqia ta refuzojë. Përcaktuesi kohor (historik) që bën dinstiksnionin midis antikës dhe dyndjes sllave në Ballkan prej nga vjen edhe origjina e maqedonasve (pa i llogaritur ëndrrallat e historianëve politikë të VMRO-DPMNE-së), më i përshtatshëm do të ishte Maqedonia e Re, ose me përcaktues gjeografikë, që tashmë kanë qarkulluar. Nuk duhet të harrojmë në asnjë moment se be-teja për emrin e ri të Maqedonisë, para së gjithash ka të bëjë me pakon e plotë, pra, atë të mënyrës së përdorimit (brenda dhe jashtë, apo vetëm jashtë), për emërtimin e gjuhës maqedonase dhe qytetarëve të saj dhe në asnjë moment nuk e prek identitetin shqiptar. Te emri i shtetit natyrisht mund të preket edhe të definimi i shtetit, ku shqiptarët mund të ndjehen të cenuar, si bie fjala emri i refuzuar kaheerë "...Sllavomaqedoni..." ose ndonjë emër tjetër i ngjashëm. Ajo që mund të supozohet është se promovimi i emrit Republika e Maqedonisë së Ilindenit, e cila preku sentimentin etnik të maqedonasve të përçarë në antikë dhe sllavë për një lloj uniteti rreth një episodi historik të pakontestueshëm, mund të jetë një emër kalimtar në procesin e negociimit, për t'i përgatitur opinionet publike të të dy vendeve për kompromisin e mundshëm. Për Greqinë, si tha Cipras, është me rëndësi që Maqedonia qenka pajtuar për emër për përdorim të përgjithshëm, kurse për palën maqedonase fakti se mund të mbrohet identiteti dhe gjuha në një emër me përcaktues kohorë ose gjeografikë...Finalja, gjithsesi, do të jetë përsëri në kuadër të propozimeve tashmë të njohura nga "defterri" i Metju Nimicit të lodhur.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

BURGU PA GARDIANË APO ARMË

Burgjet "APAC" u themeluan fillimisht nga një grup katolikësh në vitin 1972 dhe tashmë koordinohen dhe mbështeten nga organizata joqeveritare italiane "AVSI Foundation", si dhe Vëllazëria braziliane për Asistencë ndaj të Dënuarve

Në ditën e saj të parë në qelinë e re, Tatiane Correia de Lima nuk e njohu vetveten. "Ishte e çuditshme të shihja veten time në pasqyrë sërish", tha 26-vjeçarja, nënë e dy fëmijëve, e cila duhet të shlyejë një dënim prej 12 vitesh heqje lirie në Brazil. "Për një çast nuk arrita ta njihja veten".

Vendi i Amerikës së Jugut rezultoi të ketë popullsinë e katërt më të madhe të burgjeve në botë, ndërsa qelitë shpesh përfundojnë në qendër të vëmendjes për shkak të kushteve ekstremisht të rënuara, me mbipopullim të vazhdueshëm dhe dhunë të ndjeshme mes bandave, që provokojnë edhe trazira vdekjeprurëse. Lima sapo është transferuar nga një burg i sistemit kryesor penitenciar, drejt një ambienti të menaxhuar nga Shoqata për Mbrojtjen dhe Asistimin e të Dënuarve (APAC) në qytetin Itauna të shtetit Minas Gerais.

Ndryshe nga qelitë e sistemit kryesor, që sipas Limës "ta vjedh feminitetin", në burgun e APAC-ut ajo lejohet të vishet e të shihet në pasqyrë, të bëjë "make up" dhe të lyejë flokët, transmeton tch. Por dallimet mes dy lloj burgjeve janë më shumë sesa sipërfaqësore. Sistemi i "APAC"-ut po merr gjithnjë e më shumë vlerësime si më i sigurt, më i lirë dhe më human, krahasuar me burgjet e kapluar nga kriza të Brazilit.

Më 20 mars, një burg i ri nga "APAC" u hap në Rondônia, i pari në veriun e vendit, duke e çuar numrin e mjediseve të menaxhuar nga kjo shoqatë në mbarë vendin në 49 të tilla.

Të gjithë të burgosurit e "APAC"-ut duhet të kenë kaluar fillimisht në sistemin kryesor penitenciar, e duhet të kenë treguar keqardhje dhe vullnet për të ndjekur regjimin strikt të punës dhe studimit, që është edhe pjesë e filozofisë së sistemit. Aty nuk ka gardianë apo armë, ndërsa vizitorët përshëndeten nga një e burgosur, që çel derën kryesore të burgut të vogël të grave. E burgosura të shoqëron drejt një "suite bashkëshortore", një dhomë e dekoruar në mënyrë të shkëlqyer me një krevat dopio, ku femrat lejohen të kalojnë orë në privatësi me partnerët, që vijjnë e i vizitojnë nga jashtë burgut.

Burgjet "APAC" u themeluan fillimisht nga një grup katolikësh në vitin 1972 dhe tashmë koordinohen dhe mbështeten nga organizata joqeveritare italiane "AVSI Foundation", si dhe Vëllazëria braziliane për Asistencë ndaj të Dënuarve. Zëvendës-presidenti i "AVSI"-t në Brazil, Jacopo Sabatiello thotë se dashuria dhe puna janë ndër prioritetet në këto ambiente penitenciare. "Këtu, ne thërrasim cilindo në emër, e jo përmes numrave apo pseudonimeve, të cilat mund t'i kenë pasur gjatë jetës kriminale", thotë ai. Të burgosurat njihen si "recuperandos" (njerëz në rehabilitim), duke reflektuar kështu fokusin e "APAC" për një drejtësi restauruese dhe rehabilitim. Ato mund të studiojnë dhe të punojnë, shpesh në bashkëpunim me komunitetin lokal. Nëse nuk pranojnë të bëjnë këto, atëherë rrezikojnë t'u kthehen qelive të sistemit kryesor brazilian. (BBC)



AKI VERIFIKON IMAMËT, SË SHPEJTI NISIN LIGJËRATAT NË BURGJE

Sipas tij, imamët e Bashkësisë Islame të Kosovës nuk do ta zëvendësojnë punën e psikologëve dhe sociologëve, të cilët janë të angazhuar nga qendrat korrektuese. Por bashkëpunimi ka të bëjë me atë që nga qendrat korrektuese të evitohen literaturat fetare të paautorizuara, të cilat kanë depërtuar në këto qendra, dhe aty të dërgohet literaturë e autorizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës



Para disa ditësh, Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Bashkësinë Islame të Kosovës (BIK), i cili i angazhon 20 imamë që të mbajnë ligjëratat fetare në burgjet e Kosovës në përpjekje për deradikalizimin e të burgosurve.

Ligjëratat e imamëve do të mund t'i ndjekin të burgosurit që ishin pjesë e luftës në Irak dhe Siri, por edhe të burgosurit tjerë që duan të marrin mësim fetare, shkruan IndeksOnline.

Tani që kanë kaluar 11 ditë nga nënshkrimi i memorandumit, çështja e nisjes së ligjëratave ka mbetur në duar të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës (AKI).

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri ka thënë në një prononcim për IndeksOnline se janë duke pritur nga Agjencia Kosovare e Inteligjencës që të verifikoj imamët e përzgjedhur.

"Ligjëratat nuk kanë filluar ende dhe nuk do të fillojnë edhe pak. Pa përfunduar verifikimi i imamëve nga AKI-ja nuk fillojnë ligjëratat, prandaj kur të përfun-

doj ky proces, ne i ftojme ata (imamët) për të filluar procesin", ka thënë Tahiri.

Sipas tij, imamët e Bashkësisë Islame të Kosovës nuk do ta zëvendësojnë punën e psikologëve dhe sociologëve, të cilët janë të angazhuar nga qendrat korrektuese. Por, siç ka thënë ai, bashkëpunimi ka të bëjë me atë që nga qendrat korrektuese të evitohen literaturat fetare të paautorizuara, të cilat kanë depërtuar në këto qendra, dhe aty të dërgohet literaturë e autorizuar nga Bashkësia Islame e Kosovës.

Kështu nga imamët e përzgjedhur, në Burgun e Sigurisë së Lartë do të jenë të angazhuar dy imamë, Imri Llughaliu e Mehmet Fazliu, që Qendrën e Paraburgimit dhe Ndalimit në Prishtinë do të jenë të angazhuar imami Remzi Haziri dhe Idriz Xhigoli.

Në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë do të jenë të angazhuar imamët Sadi Hasani dhe Jetish Berisha, në Qendrën e Paraburgimit në Pejë imamët Muhamet Mavraj dhe Artan Zeka, në Qendrën Korrektuese në Dubravë do të jetë i angazhuar Musli Arifi.

Në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan do të jenë të angazhuar Zaim Baftiu dhe Vehbi Gajtani, në Qendrën Korrektuese në Lipjan imamët Refik Bahtiri, Lumniye Bahtiri dhe Sanije Mehmeti, në Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan do të jenë të angazhuar, Skender Mehmeti dhe Burim Arifi, në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan do të jetë imami Iljaz Mustafa, në Qendrën e Paraburgimit në Prizren do të jenë Faruk Ukallo dhe Edib Abazi dhe në Qendrën Korrektuese në veri të Mitrovicës do të jenë Rexhep Lushta dhe Irfan

Krasniqi.

Kujtojmë se në qendrat korrektuese të Kosovës tashmë gjendet një numër i qytetarëve të vendit, të cilët po e vuajnë dënimin për pjesëmarrje në luftërat e huaja, në Irak dhe Siri, por edhe për tentimin për të shkuar në luftërat e huaja.

Më herët, zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, patën theksuar se është vërejtur prania e radikalizimit në mesin e të burgosurve, madje edhe tek ata të cilët po mbajnë dënimin për vepra penale krejtësisht tjera dhe që nuk ndërlidhen me terrorizmin.

Sipas autoriteteve të Kosovës, rreth 316 persona nga Kosova kanë marrë pjesë në konfliktet në Lindjen e Mesme. Besohet se në zonat e luftës ende gjenden 140 persona, ndërkaq që në Kosovë janë kthyer 117 prej tyre.

Haradinaj takon Papën

Kryeministri Ramush Haradinaj dhe një pjesë e delegacionit me të cilin po qëndron në Vatikan, janë priturtë mërkurën në audiencë private në Selinë e Shenjtë nga Papa Françesku. Haradinaj në takim me atin e shenjtë ka qenë i shoqëruar nga zëvendësministri i Jashtëm Anton Berisha. Berisha nuk ka folur konkretisht për këtë takim, por paralajmëroj një ditë të madhe për Kosovën. "Zyra e Kryeministrit do të bej njoftimin, por ajo çfarë mund të them unë është se sot ishte një ditë e mirë dhe e madhe për Kosovën", tha ai. Ndryshe, një ditë më herët Kryeministri Ramush Haradinaj, në Vatikan, është pritur edhe nga sekretari i shtetit, Kardinali Pietro Parolin, nga i cili shefi i ekzekutivit kosovar ka kërkuar njohjen nga selia e shenjtë.

Kërkesat të larta për blerje banesash në Tiranë dhe Durrës



Ndryshe nga viti 2017, këtë vit tregu imobiliar në Shqipëri ka një zhvillim më të qëndrueshëm. Sipas agjentëve imobiliar në muajt e parë të 2018-ës, tregu shënon një trend në rritje për kërkesat për blerje të apartamenteve por edhe për marrjen e tyre me qira, sidomos nga ana e shtetasve të huaj apo edhe studentët. Tirana vazhdon të mbajë vendin e parë për shitjen, e ndjekur nga qyteti i Durrësit, ndërkohë që çmimet e shitjes së banesave në zonat e preferuara në Kryeqytet është pothuajse 50% më shumë krahasuar me qytetin bregdetar. Shumica e qytetarëve që kërkojnë të blejnë një banesë janë të prirur tek cilësia megjithatë sipas agjenteve imobiliar çmimi më i favorshëm dhe më i pranuar për xhepat e qytetarëve është deri në 70 mijë euro, shkruan scan.tv. Lidhur me ndryshimet e çmimeve të shitjeve ato janë rritur dhe zona ku ka një ndryshim drastik është ajo e Frenskut, ku çmimi është dyfishuar krahasuar me dy vite më parë.

Fajon: Zgjerimi është jetik për të gjithë Evropën

"Ka ende disa vende të Ballkanit Perëndimor që kanë probleme të korrupsionit dhe krimit të organizuar, demokracisë dhe lirisë së shtypit. Të gjitha këto janë çështje për të cilat rajoni ka nevojë të përmirësohet dhe ne do t'i ndihmojmë edhe në biznes", thotë Fajon



Eurodeputetja Tanja Fajon thotë se qëndrimi i presidentit francez Emanuel Makron për Ballkanin Perëndimor duhet të jenë i "ankoruar" me Bashkimin Europian, dhe nuk mund të zëvendësohet procesi i anëtarësimit të BE-së në rajon.

Ajo ka thënë se paqja dhe stabiliteti i Ballkanit Perëndimor janë

arsyeje pse zgjerimi është jetik për të gjithë Evropën. Fajon beson se Franca ka një qëndrim të ashpër mbi zgjerimin dhe se ajo që ka të bëjë me këtë vend është çështja e sigurisë dhe azilkërkesit e rremë, të cilët ende vijnë kryesisht nga Shqipëria dhe Kosova.

"Franca, megjithatë, nuk është i vetmi vend. Ka edhe vende të tje-

ra që kanë interesa të mëdha. Unë ende shpresoj se Franca do të deklarohet edhe rreth çështjes së Shqipërisë", thotë Fajon.

Ajo thotë se është optimiste dhe shpreson që në qershor vendet anëtare të BE do të miratojnë hapjen e negociatave për pranimin e Maqedonisë dhe Shqipërisë, ku sipas fjalëve të saj, do të ishte një

hap pozitiv për të gjithë procesin e zgjerimit, transmeton lajmi.net.

"Ka ende disa vende të Ballkanit Perëndimor që kanë probleme të korrupsionit dhe krimit të organizuar, demokracisë dhe lirisë së shtypit. Të gjitha këto janë çështje për të cilat rajoni ka nevojë të përmirësohet dhe ne do t'i ndihmojmë edhe në biznes. Në të njëjtën kohë dhe në BE duhet të flasim për aspektet pozitive të zgjerimit dhe pse ne kemi nevojë për njëri-tjetrin", thotë Fajon.

Ajo thotë se është pozitive që Ballkani Perëndimor pas një kohë të gjatë përsëri e ka fokusin e BE-së.

Fajoni i tha Tanjugut se takimi i nivelit të lartë në Sofje dha mesazh "ndoshta jo shumë ambicioz" por "të qartë" të perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor.

Ajo shton se është e vështirë të flitet për datat, por gjithashtu vë në dukje se "ku ka vullnet politik, ka një proces më të shkurtër".

Trump, praktikisht i ka kthyer shpinën Evropës, për t'iu bashkuar një aleance të pazakontë mes Arabisë Saudite dhe Izraelit, dy vende që po u bien daulleve të luftës me Iranin

Donald Trump ka vazhduar me agjendën e tij të prishjes së rendit botëror ashtu si e njohim. Është tërhequr nga shumë marrëveshje, u ka kthyer shpinën aleatëve evropianë, të cilët mund të kundërpërgjigjen. Dhe në Lindjen e Mesme, me veprimet që po bën, mund të jetë duke nxitur një garë armatimi dhe në fund, një luftë. Ai e ka thënë gjithmonë, që do ta vendoste Amerikën të parën. Tani duket se për Presidentin Trump, kjo nënkupton Amerika e Vetme. Që kur erdhi në pushtet vitin e kaluar, Trump ka bërë gjithçka për të izoluar SHBA nga aleatët e vet tradicionalë, dhe prishur rendin e brishtë botëror, shkruan Barbara Slabin në "The Hill".

Në vitin 2017, ai sfidoi kritikët duke tërhequr SHBA nga marrëveshja e klimës e Parisit. Trumpi është tërhequr edhe nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Trans Paqësorit; ka vazhduar me kritika ndaj NATO-s; ka kërcënuar me tarifa të reja tregtare që do të kishin ndikim mbi prodhuesit evropianë; ka dëmtuar procesin e paqes në Lindjen e Mesme duke zhvendosur ambasadën e SHBA në Jerusalem; dhe ka tërhequr SHBA nga marrëveshja bërthamore me Iranin, e vitit 2015.

Në ditët para se Trump të bënte atë shpallje javën që kaloi, presidenti i Francës, Emmanuel Macron dhe kancelarja gjermane, Angela Merkel, kishin udhëtuar në Uashington për t'iu bërë thirrje presidentit që të ndryshonte mendje. Por më kot.

Nuk duhej të habiteshim

DONALD TRUMP DHE ZHBËRJA E RENDIT BOTËROR



aspak, shkruante The Independent. Trump, sërish, po përmbush te një premtime që kish bërë gjatë fushatës elektorale, si dhe po vazhdon te misionin e tij "fëmijëror" për të "zhbërë" – thjesht për hir të të zhbërës – gjithçka që paraardhësi i tij ka arritur në detyrë.

Por dalja nga marrëveshja me Iranin bën dallim nga të tjerat, shkruante Philip Stephens në "Financial Times": ajo shënon "shkëputjen më të madhe në marrëdhëniet transatlantike, që nga fundi i Luftës së Ftohtë".

Trump, praktikisht i ka kthyer shpinën Evropës, për t'iu bashkuar një aleance të pazakontë mes Arabisë Saudite dhe Izraelit, dy vende që po u bien daulleve të luftës me Iranin.

Por Trump kishte të drejtë për një gjë: marrëveshja me Iranin nuk ishte e mirë, shkruante Janet Daley në "The Sunday Telegraph".

Sigurisht, u shkonte për shtat evropianëve që të kishin mundësi

të bënin biznes me Iranin – Franca dhe Gjermania kanë përfituar jo pak prej saj, dhe tashmë janë trembur se sanksionet e SHBA do ndalin një treti që vlen miliarda. Por marrëveshja nuk kërkonte mjaftueshëm nga Irani në këmbim: ai do i mbante raketat balistike me rreze të gjatë veprimi; bazat e tij ushtarake nuk du nënshtroheshin inspektimeve; dhe atij i ishte kërkuar vetëm të pezullonte, jo të mbyllte, programin e vet bërthamor. Ideja optimiste e Barak Obamës ishte se gjatë pauzës 10-15 vjeçare, ekonomia e Iranit do të lulëzonte, dhe të rinjtë e të moderuarit properëndimorë do të përparonin, duke e zbutur kështu mbërthimin e teokracisë shiite.

Por Teherani nuk i përdori të ardhurat shtesë për të përmirësuar jetët e njerëzve. Ai i përdori për të fuqizuar harkun e influencës shiite në rajon, duke financuar terrorizmin dhe inkursionet ushtarake

në Jemen (ku Irani po lufton një luftë përmes të tretëve, me Arabinë Saudite), Siri (ku Izraeli pretendon se 80 000 luftëtarë shiite janë nën kontrollin iranian), Liban (ku armiku i Izraelit, Hezbollahu i mbështetur nga Teherani është një forcë e madhe) dhe në Irak. Shkurt, shkruante The Daily Telegraph, vendimi i Trumpit për t'iu tërhequr nga marrëveshja merr më shumë kuptim, sa më pranë Iranit që të jetosh.

Po çfarë pret ai që të ndodhë tani? Në Evropë, tre M-të – Macron, May dhe Merkel – ende shpresojnë ta shpëtojnë marrëveshjen, shkruante Eduard Luce në "Financial Times". Presidenti i Iranit, Rouhani thotë se, nëse gjejmë një mënyrë për ta vazhduar tregtinë, ai do i përmbahet. Por kjo gjë çon në një thellim të ndarjes në përfundim: SHBA do vendoste sanksione ndaj enteve evropiane dhe Evropa do të detyrohej të kundërpërgjigjej. Sigurisht, firmosësit e tjerë të marrë-

veshjes, Kina dhe Rusia, do të vazhdonin të bënin tregti me Iranin dhe do të kundërpërgjigjeshin ndaj penaliteteve të mundshme prej SHBA. Kjo do të kishte një efekt të drejtpërdrejtë mbi bisedimet e Trumpit me Kinën, si dhe shpresat që Pekini të ruajë trysinë mbi Korenë e Veriut, që ajo të braktisë armët bërthamore.

Nuk është e qartë se si, duke hequr dorë nga kjo marrëveshje, Donald Trump shpreson të bind Kim Jong Un që t'iu besojë atij, kur të vijë puna tek Koreja e Veriut, shkruante FT. Por i fuqizuar nga ai që duket si sukses me Kimin, Trumpi ka besim se mund të sigurojë një marrëveshje më të mirë prej Iranit, në 90 deri 180 ditët para se të rivendosen sanksionet. Është një strategji me risk të lartë. Po sikur ndjekësit e vijës së ashpër në Iran – të cilëve asnjëherë nuk u pëlqeu marrëveshja e 2015-ës – të përdorin tradhtinë e Satanit të Madh, për t'iu forcuar? Në vend që të kthehen në tryezën e negociatave, ata mund të detyrojnë popullin që të durojë dhimbjen e sanksioneve, dhe të rifillojnë programin bërthamor, duke nxitur kështu një garë armatimi në Lindjen e Mesme.

Trump është i përgatitur për atë rezultat, shkruante Christopher de Bellaigue, në "The Spectator". Ai është i rrethuar nga anti-iranianë, duke përfshirë John Boltonin, këshilltari i tij i sigurisë kombëtare, i cili prej kohësh ka bërë thirrje për ndryshim regjimi në Iran. Nëse nuk ka kapitullim të stilit të Koresë së Veriut, ndoshta do të kemi luftë. Irani është fuqi e keqe, shkruante "Uashington Post". Por është edhe një qytetërim i lashtë, me lidhje komplekse influente në rajon, i cili i ka rezistuar për dekada të tëra trysnisë dhe sanksioneve të Amerikës. Edhe nëse do mundeshim ta rrëzonim regjimin, a do e dëshironim këtë gjë? Sigurisht, pas 20 viteve të fundit, nuk mund të hapim kutinë e Pandorës.

(The Week)

BREXIT-i shton nënshtetësitë gjermane të britanikëve

Të nxitur nga perspektiva e tërheqjes së Britanisë nga Bashkimi Evropian vitin e ardhshëm, numri i mbajtësve të pasaportave britanike, të cilët u bënë shtetas gjermanë, u rrit për 162 për qind vitin e kaluar, tha të mërkurën Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë.

Rreth 7,500 britanikë morën shtetësinë gjermane vitin e kaluar. Kjo përcillet nga rritja prej 361 për qind në vitin 2016, duke e çuar numrin brenda dy vjetëve në rreth 10,400. Thënë ndryshe, është më shumë se dyfishi i britanikëve që u bënë gjermanë në 15 vjet nga viti 2000, raporton Reuters.

"Është e dukshme lidhja me Brexitin", ka thënë Zyra, duke shtuar se britanikët ishin grupi i dytë më i madh që morën shtetësinë gjermane vitin e kaluar pas turqve që ishin në rreth 15 mijë, transmeton Koha.net.

Si pasojë e Brexitit, i cili pritet të finali-



zohet marsin e vitit 2019, shumë britanikë po brengosen se do të humbin të drejtën e jetesës dhe punës në ekonominë më të madhe evropiane, e cila po gëzon një periudhë jashtëzakonisht të gjatë të zhvillimit dhe numër të ulët rekord të të papunëve.

Në përgjithësi, numri i njerëzve që u bënë gjermanë u rrit për 1.7 për qind vitin e kaluar në 112,200 sosh, që është niveli më i lartë që nga viti 2013.

Parlamenti Evropian, Zuckerbergut: KE KRIJUAR NJË MONSTËR

Mark Zuckerberg i ftuar për t'iu përgjigjur pyetjeve të eurodeputetëve iu përgjigj atyre vetëm në mënyrë të përgjithshme ose nuk dha përgjigje për një sërë pyetjesh. Deputetët e parrajmëruan për krijimin e një monstre.

Deputetë të Parlamentit Evropian u shprehën të zhgënjyer për dëgjuesën me shefin e Facebookut, Zuckerberg. Rrjedha e aktivitetit parashikonte që në fillim të bësheshin të gjitha pyetjet dhe pastaj ato të merrnin një përgjigje në grup.

Por shefi i Facebookut për shumë pyetje nuk dha përgjigje. Zuckerbergu u mjaftua me mini-deklarata të përgjithshme për disa nga temat e përmendura. Përgjigje të detajuara Facebooku do të japë më pas, u shpreh 31 vjeçari në fund të dëgjuesës. Shefi i Grupit Parlamentar të Li-



beralëve, Verhofstadt paralajmëroi se Zuckerbergu mund të hyjë në histori si ai, që ka krijuar një monstër digjitale, që i shkatërron demokracitë tona.

Shkas për dëgjuesën ishte përcjellja ilegale e të dhënave të Facebookut dhe përdorimi i tyre për shembull në fushatën elektorale të Donald Trumpit ose në votimin për Brexitin në Britaninë e Madhe.

(DW)

Kaluam përsëri pikat e kontrollit të milicisë përsëri. Qielli u errësua. Një makinë e bardhë u shfaq pas nesh, duke mbajtur distancën dhe duke ndjekur kthesat tona. Kemi kaluar një shkollë dhe nga muret kemi dëgjuar zërat e fëmijëve që luajnë. Një shenjë pranë portës tha se shkolla e Abbasidit, e cila, ne e kuptuam, është vendi ku janë ekzekutuar burrat Sabarëve



Nga Anand GOPAL

OKB gjeti një model të ngjashëm. Në Sinsil, provincën Diyala, për shembull, forcat irakiane thuhet se i vunë zjarrin një baze ushtarake që mbante 53 sunitë. "Dëshmitarët zbuluan trupat e tyre: disa nuk mundej të identifikoheshin; të tjerë u dogjën vetëm pjesërisht, duke zbuluar plagë me armë zjarri, plagë të rënda dhe gjymtyrë të thyer".

Disa milicite shiite u morën edhe me propagandën e tmerrshme. Një video paraqiste një komandant të milicisë i cili e shtyu një njeri të djegur - me sa duket një luftëtar ISIS - dhe e copëtoi atë si shawarma. Në një tjetër, luftëtarët u prenë kokën dy robërve. Për shkak se viktimat nuk ishin perëndimorë, video të tilla morën pak popullaritet në nivel ndërkombëtar, por midis sunitëve ata dërguan një mesazh të frikshëm. Falahu pa Wissamin të zbriste, pastaj Jamal, dhe pastaj Samirin. Pastaj gjithçka u errësua.

Falah dhe Abu Ammar u ndjenë të sigurt se sunnitët e Anbarit do të bashkoheshin së bashku për të përmbysur ISIS dhe t'i jepnin fund sundimit tiranik. Por një kryengritje e bashkuar sunitë tani duket një fantazi. Edhe ideja e sunive si një entitet koherent është një mit i botës pas vitit 2003. Që nga fundi i vitit 2013, elita sunniti është ndarë në tri mënyra: Disa janë bashkuar me ISIS; disa kanë shkuar në Bagdad, e kanë lidhur fatin e tyre me qeverinë dhe kanë ndihmuar për të drejtuar milicite sunitë që punojnë me forcat irakia-

FEJTON: FERRI PAS ISIS-IT (9)

KRIMET E FORCAVE IRAKIANE, E NJËJTA METODË SI E ISIS-it



ne të sigurisë; dhe të tjerët kanë ikur në Kurdistanin e Irakut ose në Aman, Jordani, ku ata kanë aleatë shtetet fqinje sunitë.

Shumë në këtë ëndërr të fundit të grupit kanë anashkaluar qeverinë e Irakut dhe marrin direkt armë amerikane dhe para për të luftuar ISIS. Por për këto elita sunitë, gjithsesi armiku mbetet të jetë Shteti Islamik. Shumë prej tyre janë nostalgjikë për sundimin Baathist dhe refuzojnë të pranojnë realitetin e shumicës shiite. Një përpjekje e jashtme për t'i armatosur ato mund të çojë në shpërbërjen e Irakut, pasi ushtritë fisnore në mënyrë të pashmangshme i kthejnë armët e tyre në qeverinë e mbizotëruar nga Shia.

Jordania, Arabia Saudite dhe Turqia, në shkallë të ndryshme, mund ta përqafojnë këtë rezultat. Ndërkohë, shumë sheikë që u ba-

Për sabarët dhe shumë të tjerë, vendosja e një etikete si terrorist, në anën tjetër, është një privilegj që kundërshton zgjedhjet e tmerrshme që kjo luftë kundër ISIS-it i ka bërë për ta. Kur kam folur së fundi me Abu Ammar, në dhjetor, ai ishte në një nxitim. Salam, djali i vetëm i mbijetuar i Falahut, kishte qenë në qytet në pushim dhe po përgatitej të largohej. Ai ishte tani i vetmi familjar i familjes së tij, dhe arritjet dhe nisjet e tij ishin bërë raste për tubime familjare.

shkuan me ISIS janë penduar për vendimin e tyre, pasi u zhveshën nga fuqia dhe pasuria që kishin. Ata që kanë kundërshtuar janë burgosur, torturuar dhe në disa raste janë ekzekutuar. Pas një periudhe lufte, sunitët ndahen jo vetëm midis fiseve por edhe brenda tyre. Shumë fise tani kanë dy sheik të lartë, një në Erbil, kryeqyteti i Kurdistanit irakian dhe një në Bagdad. Thyerjet kalojnë edhe

vijën: nëse largohuni nga vilat luksoze të sheikëve, rëndë se do të gjeni një sunni që ka fjalë të mira për udhëheqësit e tij ose të saj. "Çdo njëri prej tyre," më tha një refugjat nga Hit, "është një kriminel".

RRËMUJA E SUNITËVE

Derisa bashkësia sunniti është në rrëmuje, vetë ISIS është pak më mirë. Entuziazmi i popullarizuar për sundimin e tij në vende si Hit



është zhdukur, që do të thotë se nuk ka qenë në gjendje të mbajë territor ose të përparojë në Bagdad. Nën presionin ushtarak të ushtrisë irakiane, militantëve shiitë dhe sulmeve ajrore të Shteteve të Bashkuara, Shteti Islam po ngulfatohet ngadalë: Në dhjetor, ai humbi Ramadin. Në mars, forcat irakiane filluan të përparonin në Hit.


Por shumë sunitë do t'ju tregojnë se edhe nëse kjo fushatë arin të rrënojnë ISIS, ajo nuk do të ketë bërë asgjë për të trajtuar ndarjet themelore që ndihmuan në krijimin e grupit në radhë të parë. Këto përçarje janë rezultat i dekadave të politikës amerikane dhe keqtrajtimit nga Sadami, dhe ata do të mbeten edhe gjatë kohë.

Refugjatët suni që kam takuar kanë pak shpresë për një Irak paqësor; çfarëdo ideje që ata mund të kenë pasur në lidhje me rimarrjen e vendit të tyre në shoqërinë irakiane ose zhdukjen e sundimit të mbizotëruar nga Shia, janë zhvendosur, zëvendësuar nga imperativi më themelor i të gjithëve: Qëndroni të gjallë. "Unë kurrë nuk dëshiroj të kthehem," më tha një punëtor ndërtimi i quajtur Mohammed, i cili kishte arritur të ikë nga Falluxha, i kontrolluar nga ISIS. "Edhe nëse bie, të gjithë po përpiqen të dalin, të ikin sa më larg nga Iraku".

Një ditë në nëntorin e kaluar, në një restorant rrugor në lagjen qendrore Masbah të Bagdadit, takova një kuzhinier me emrin Abdul Hamid. Ai më tha se më parë gjatë javës, një familje shiite u mblodh pranë shtëpisë së tij për të varrosur një djalë 11-vjeçar i cili kishte vdekur nga dizenteria. Sipas traditës, familja kishte ngritur një tendë për të nderuar të ikurin dhe për të ofruar ushqim dhe ëmbëlsira për kalimtarët. Rreth mesditës, një njeri kishte depërtuar përmes turmës, arriti tryezën e ushqimit dhe pijeve dhe shpërtheu. "Ishte një shpërthim i tmerrshëm," më tha Hamid. "Trupat u shpërndanë tërësisht".

Kushëri i Hamidit ishte gjithashtu i pranishëm atë ditë. Kohët e fundit ai kishte vendosur të vullnetonte për linjat e para për të luftuar ISIS. Në total, 18 vetë u vranë, të gjithë shiitë, duke përfshirë një sheik dhe një vajzë 7-vjeçare.

Sulmi vetëm një nga bombat e makinave dhe sulmet vetëvrasëse - strategjia e Shtetit Islamik për



të terrorizuar komunitetet shiite dhe për të thelluar përçarjen sektare të vendit. Nëse ISIS do të kapnin Bagdadin disi, kërcënimin ndaj shiitëve do të ishte ekzistencial. Kjo sugjeron se pas ngritjes së shovinizmit shiit, milicisë dhe abuzimit të sunitëve qëndron logjika e papërpunuar e mbijetesës. Merrni një shembull: Në vitin 2014, milicia pushtoi Jurf as-Sakhar, në jug të Bagdadit, nga ISIS dhe i ndalo të gjithë civilët sunitë, domethënë mijëra humbën shtëpitë dhe pronat e tyre. Por gjatë vitit në vijim, u sh-tua numri i makinave bomba.

KTHIMI TË SHTËPIA KU KISHIN QËNDRUAR SABARËT

Shikuar në këtë dritë, ikonografia e lagjes që kishte shkaktuar kaq paqëndrueshmëri të Sabarët në Bagdad - posterat e dëshmorëve shiitë, tabelën e ajatollahëve - duket më pak si agresioni sektar dhe më shumë si sfidë. Pyes veten se si shiitët e zakonshëm do të shohin tragjedinë e Sabarëve. Nëse një milicia shiite i kishte dëbuar nga lagja e tyre, a ishte një familje shiite që tani jetonte në vendin e tyre? Nëse po, kush ishin ata? A i njihnin ata rrethanat e këqija nën të cilat kishin marrë shtëpinë e tyre të re?

Vendosa të vizitoj shtëpinë dhe të gjej. Në fund të vitit të kaluar, Abu Ammar, i cili ishte punësuar si një shofer taksi midis Kurdistanit dhe Bagdadit, pranoi të më tregonte se ku qëndronte. Duhet të jemi të kujdesshëm: Familja kishte jetuar në një zonë që thuhet se ishte nën kontrollin e Asaib Ahl al-Haq, "Lidhja e të Drejtëve", ndoshta më vdekjeprurëse nga të gjitha milicite irakiane. Grupi besohet të jetë i trajnuar dhe i financuar nga Forca Revolucionare e Kudsit në Iran, dhe kreu i kapitullit lokal thuhet se është një kriminel dikur i cili u ngrit gjatë okupimit amerikan për kryerjen e rrëmbimeve dhe prerjeve të kokës. Sipas disa banorëve me të cilët bisedova, asnjë aktivitet nga milicia nuk ndodh në lagje pa miratimin e tij.

Ne arritëm vonë pasdite. Me ne ishte përkthyesi im, një mik të cilin do ta quaj Hashim. Hayy al-Xhahadi ishte një shpërthim i ngjyrës: postera magenta, postera me ngjyra të ndezura, flamuj të zinj për zi, të kuqe për hakmarrje. Këtu dhe atje, kaluam pikat e kontrollit të njerëzve të armatosur në bluza dhe pantallona maskuar. Çdo shtëpi dhe dyqan kishin slogane dhe flamuj shiitë përpara. Kaluam disa burra me mitralozë që qëndronin në një qoshe të rrugës. Abu Ammar vuri në dukje shtëpinë, dhe më pas për sigurinë e tij u larguam nga lagja për ta liruar atë.

Kaluam përsëri pikat e kontrollit të milicisë përsëri. Qjelli u errësua. Një makinë e

bardhë u shfaq pas nesh, duke mbajtur distancën dhe duke ndjekur kthesat tona. Kemi kaluar një shkollë dhe nga muret kemi dëgjuar zërat e fëmijëve që luajnë. Një shenjë pranë portës tha se shkolla e Abbasidit, e cila, ne e kuptuam, është vendi ku janë ekzekutuar burrat Sabarëve.

Duke arritur te shtëpia, unë pashë se makina e bardhë na kaloi dhe u futëm. Porta e përparme ishte një vaskë e venitur, me një pjesë të madhe të ndryshkut. Një flamur gjigant që përkujtonte martirët shiitë u përkul nga shtëpia në vendin fqinj dhe rrihte kundër çatisë. Ajo ishte tashmë e errët-një dritë e rrugës kishte ardhur dhe unë trokiti në derë. Pa përgjigje. Trokitja përsëri dhe prita. Nuk kishte dritë brenda. Erëza e ujërave të zeza nga hulli i hapur po më bënte të trulllos, dhe papritmas vura re se toka e ndryshkut në portë ishte e valëzuar. E zgjata për ta prekur, por Hashimi më ndaloi. "Shikoni," tha ai. "Ata janë mizat". Ishin qindra prej tyre, një masë zvarritëse. Shiu filloi të binte. Disa fëmijë nga lagja filluan të endeshin. Ne vendosëm të iknim.

SËRISH NË LUFTË KUNDËR ISIS

Kam vërejtur, lidhur me portën, një alegë, një leckë të gjelbër për të tërhequr bekimet dhe për të shmangur shpirtrat e këqij, të zakonshëm mes shiitëve. Ishte një shenjë e dominimit apo e shlyerjes? Ndoshta një shenjë pendimi nga lagja, apo edhe nga dikush që lidhet me milicite? Pavarësisht kësaj, shtëpia ishte e braktisur në mënyrë të qartë. Një familje sunnite ishte dëbuar, por asnjë familje shiite nuk dukej e rehatshme. Pavarësisht nga cikli i hakmarrjes, vrasjet e fshehta, ndoshta kjo nuk ishte lojë zero. Një veprim i dhunës kundër sunive nuk ishte, në më të paku në këtë rast, fitimi i komunitetit shiit.

Më vonë, thirra Abu Ammar për të përshkruar atë që kisha gjetur. "Që nga aksidenti," tha ai, "gjithmonë besoj se kishte njerëz në lagje, shiitë, të cilët ishin përpjekur të na ndihmonin. Nuk e di, por ndoshta kjo është arsyeja pse burri erdhi në shtëpinë tonë një natë më parë, për të na paralajmëruar".

Ishte e çuditshme që familja e përdor gjithmonë këtë fjalë - aksident - për të përshkruar masakrën. Ndoshta kur retorika zyrtare është e përcaktuar aq qartë, kur është e kuptueshme si distilimi i së keqes së pastër, nuk mbetet asnjë gjuhë për të përshkruar apo kuptuar anën tjetër.

Për sabarët dhe shumë të tjerë, vendosja e një etikete si terrorist, në anën tjetër, është një privilegj që kundërshton zgjedhjet e tmerrshme që kjo luftë kundër ISIS-it i ka bërë për ta.

Kur kam folur së fundi me Abu Ammar, në dhjetor, ai ishte në një nxitim. Salam, djali i vetëm i mbijetuar i Falahut, kishte qenë në qytet në pushim dhe po përgatitej të largohej. Ai ishte tani i vetmi familjar i familjes së tij, dhe arritjet dhe nisjet e tij ishin bërë raste për tubime familjare. Ishte mëngjes herët dhe Abu Ammar ishte gati për të përcjellë Salamin në aeroport. Salami ishte veshur me bluza blu dhe një beretë. Ai po shkonte sërish në llogore të Anbarit, armë e vendosur mbi shtatullën e tij dhe ID të qeverisë në dorë, për të luftuar Sh-tetin Islamik. (fund)

Ky shkrim është shkruar nga Anand Gopal, autor i librit "Asnjë njeri i mirë mes të gjallëve: Amerika, talebanët dhe lufta në sytë afgane". Teksti është botuar në "The Atlantic", i përkthyer dhe përshtatur nga "KDPolitik.com".

Publicitet



KOMUNA E KARPOSHIT

DEPARTAMENTI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN



Në bazë të nenit 15, paragrafi 1, pika 2, si dhe nenit 6 të Ligjit për Qytetin e Shkupit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 55/04 dhe 158/11), nenit 21, nenit 36, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 62 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 5/02), ndërsa në lidhje me Programin për aktivitetet e Komunës së Karposhit në sferën e ekologjisë dhe efikasitetit energjetik për vitin 2018 ("Fleta Zyrtare" - Komuna e Karposhit nr. 18/17), pjesa II pika Aktivitetet projektuese, pika 1. Departamenti për ekologji, nënpika 1.6. Subvencionimi i blerjes së biçikletave, dhe në bazë të Vendimit për dhënie të pëlqimit për publikim të shpalljes dhe realizim të procedurës për miratim të subvencioneve për banorët e Komunës së Karposhit për blerje të biçikletave të reja nr. 09-4263/4 të datës 22.05.2018 ("Fleta zyrtare nr. 5/18), Komuna e Karposhit publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për miratim të subvencioneve për banorët e Komunës së Karposhit për blerje të biçikletave të reja

Komuna e Karposhit prej më 28.05.2018 (e hënë) fillon me realizimin e aksionit "Karposhi me biçikletë", me të cilin do të subvencionohet 30% e çmimit për blerje të biçikletës së re, ose në shumë maksimale fiskale, më së shumti deri në 3.000 denarë. Të drejtë për subvencionim në këtë aksion do të ketë secili banor i rritur i Komunës së Karposhit, i cili do të blejë biçikletë të re duke filluar prej më 28.05.2018 (e hënë). Dokumentet e nevojshme për subvencionim të biçikletave janë:

- Letërnjoftimi (fotokopje)
- Llogaria e transaksionit (fotokopje)
- Llogaria fiskale me vërtetim llogaritës (origjinal) ose faturë për biçikletë të blerë, e cila është blerë jo më herët se 28.05.2018 (e hënë).
- Banorët të cilët tash më kanë realizuar të drejtën e subvencionimit dhe kanë marrë mjetet për të njëjtën nga Qyteti i Shkupit, nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje në shpallje.

Kërkesat së bashku me dokumentacionin e kompletuar do të parashtrihen tek koordinatori i projektit Marko Petrushevski, çdo ditë pune (prej ditës së hënë deri ditën e premte), prej ora 07:30 deri në ora 15:30 në lokalet e Komunës së Karposhit (kati i dytë i shkollës fillore "Llazo Trpovski" rr. Dragisha Mishoviq, hyrja e pasme e Komunës) Pas parashtrimit të dokumenteve, parashtruesit e formës me shkrim do të informohen nëse do të jenë shfrytëzues të mjeteve të parapara për subvencion për blerje të biçikletës së re. Ky aksion do të zgjasë deri në harxhimin e mjeteve, ndërsa do të vlejë parimi "i pari i ardhur, i pari i shërbyer".

E drejta e subvencionimit është e njëhershme.

Për të gjitha informatat shtesë, qytetarët do të mund të drejtohen tek koordinatori i projektit Marko Petrushevski.

Telefoni për kontakt: 078/432/653



Republika e Maqedonisë
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit
Hapësinor



Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë

SHPALL

Kërkesa për dhënie e Lejes për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga një trup nëntokësor për nevojat teknologjike të një baze betoni dhe ndarjes së rërës.

Sipas nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për Ujërat ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është dorëzuar Kërkesë për kaptazhin dhe përdorimin e ujit nga një trup nëntokësor për nevojat teknologjike të një baze betoni dhe ndarjes së rërës.

Parashtruesi i kërkesës:
"Euro-Beton" SHPKNJ qyteti, Dellçevë
Qyteti Dellçevë

Pusi ndodhet në PK 4047/1 KK Komuna e Dellçevës me koordinatat e mëposhtme sipas sistemit kombëtar të koordinatave:

X=4 644 035 Y=7 650 729

Pika e lëshimit të ujit, e pastruar përmes një precipituesi, gjendet në PK 5464 KK Komuna e Dellçevës me koordinatat e mëposhtme sipas sistemit kombëtar të koordinatave:

X= 4 643 864 Y=7 650 531

Informata lidhur me kërkesën, publiku i interesuar mund të merr në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail b.apostolova@moepp.gov.mk

Publiku i tanguar, brenda 15 ditëve nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë të paraqesë mendime dhe komente me shkrim në bulevardin "Goce Dellçev" nr. 18, në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, në RTM (kati 10), 1000 Shkup.

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

SHUHET NË MOSHËN 85-VJEÇARE SHKRIMTARI AMERIKAN PHILIP ROTH

“New York Times” raportoi edhe shkaku të vdekjes, bazuar nga rrëfimi i një miku të ngushtë të Rothit, që ishte pushimi i zemrës si pasojë e bllokimit

Philip Roth, një prej shkrimtarëve më të mëdhenj amerikanë, ka ndërruar jetë në moshën 85-vjeçare. Fitues i çmimit “Pulitzer”, Çmimit Kombëtar të Librit dhe çmimit ndërkombëtar “Man Booker”, ai është frymëzuar për veprat e tij nga jeta e familjeve hebreje, seksi dhe idealet amerikane.

Mes veprave të tij janë “American Pastoral”, “I Married a Communist” dhe “Portnoy’s Complaint”.

“New York Times” raportoi edhe shkaku të vdekjes, bazuar nga rrëfimi i një miku të ngushtë të Rothit, që ishte pushimi i zemrës si pasojë e bllokimit.

Roth nisi rrugën e suksesit përmes një koleksioni tregimesh të shkurtër, “Goodbye Columbus”, të publikuar në vitin 1959. Një dekadë më vonë, novela e tij kryesisht seksuale “Portnoy’s Complaint” (Ankimi i Portnoit) e katapultoi atë drejt famës, duke e bërë një nga më të shquarit në Shtetet e Bashkuara.

Në vitet e mëvonshme të jetës, ai shkroi edhe një sërë novelash historike, përfshi veprën e vitit 1997 “American Pastoral”, për të cilin fitoi edhe çmimin “Pulitzer”. Gjatë karrierës së tij ka botuar mbi 30 libra, përpara se t’i jepte fund karrierës së pasur në vitin 2009.

Vdekja e Rothit vjen vetëm një javë pas shuarjes së një tjetër peshë të madhe si Tom Wolfe, autor i “Bonfire of the Vanities”, që ndërroi jetë në moshën 88-vjeçare.

Si mund ta njohësh një autor, për të cilin ke dëgjuar vetëm të fliet? Ndoshta është më mirë t’i referohesh librit të tij të parë. Për shkrimtarin amerikan, Philip Roth, ndoshta ky lexim duhet filluar nga “Ankimi i Portnoit”. Ky libër, i treti në karrierën e Roth, bëri të disku-



tohej gjatë për të si autor. I botuar në vitin 1969, romani u kritikua për përshkrimet seksuale dhe të masturbimit, e madje u quajt edhe skandaloz nga një pjesë e mirë e kritikës. Së fundmi, ky libër ka ardhur edhe për lexuesin shqiptar nga shtëpia botuese “Skanderbeg Books”, e cila ka publikuar edhe libra të tjerë nga shkrimtari amerikan si “Inati” apo “Del Hija”. Për këtë libër është shkruar shumë deri më sot. Përveç përjetimit personal të leximit, mjafton të futesh në kërkim online dhe blogjet në të cilat diskutohet për të janë të pafundme. Distanca kohore prej gati 40 vjetësh, tashmë e bën gjykimin edhe më të lirshëm. “Ankimi i Portnoit” është cilësuar si një libër i revolucionit seksual, një monolog erotik e njëkohësisht libri më komik për seksin. Aleksandër Portnoi është ulur dhe po rrëfëhet përballë psikanalistit të tij për çfarë ka ngjarë me seksin, epshin, obsesionin, joshjen, lojërat dhe vuajtjet e tij seksuale. Në të vërtetë, rrëfimi i tij është një monolog i gjatë i një djaloshi të varur plotësisht nga seksi, të diktuar nga epshi dhe kureshtja ndaj nënës së tij dhe nga një përkujdesje fatale për të mos i cenuar kodet morale të përcaktuara nga brezat e familjes së tij, trysni kjo e dhënë nga Philip Roth përmes një rrëfimi sa komik, aq edhe të vërtetë e të dhimbshëm. Një çrregullim trupor, i ndikuar sa nga fiziku, aq edhe nga etika familjare e prejardhjes së Portnoit, si dhe impulset e tij altruiste, përpla-

sen me një dëshirë të skajshme seksuale të tij, shpesh edhe me natyrë perverse, që e bëjnë Aleksandër Portnoin të gjendet shpesh në situata të vështira.

Për shkak të kohës kur është botuar, “Ankimi i Portnoit” cilësohet si një roman emblematic, pasi iu përgjigj me idetë e tij valës së revolucionit seksual që përfshiu fundin e viteve ‘60. Menjëherë pas botimit, libri provokoi një debat të gjerë publik për shkak të përsiatjeve dhe analizave të tij mbi seksualitetin dhe obsesionin mbi seksin, si dhe përshkrimeve pa tabu mbi vetëkënaqjen, reaksion ku veçmas u përfshinë edhe intelektualë hebrej të Amerikës. Philip Roth njihet si një shkrimtar i “heshtur”. Intervistat e tij nuk janë të shumta, por edhe në rastet kur ndodhin, nuk ia arrijnë qëllimit të tyre. Janë të kursyer në fjalë dhe argumentet ndoshta nuk marrin shpesh përgjigjen e kërkuar. Roth flet ftohtë për këtë prije të tij të të trajtuarit të seksualitetit në librat e tij. “Më ka interesuar gjithmonë të kuptoja se çfarë ndodh në jetën e personave kur në mes hyn seksi. Ka qenë një temë me shumë rëndësi, edhe pse tani nuk më tërheq më si dikur”, thekson shkrimtari. Në një intervistë të tij pak kohë pas botimit të librit, Roth është shumë i kursyer në shpjegime përpara furtunës që shkaktoi libri. Këtë monolog erotik pa tabu, për habi të të gjithëve ai e sheh më shumë si një çështje letrare, një çështje stili se sa parimesh. “Disa ide

që më pas i kam shkruar në librin tim, më qarkullonin në mendje që nga koha kur kam filluar të shkruaj. I referohem veçanërisht ideve mbi stilin e rrëfimit. Libri është i ndërthurar mbi teknikën e ‘bllokimit të ndërgjegjes’, ku copëza materiale të formës dhe dimensioneve të ndryshme, vendosur njëra mbi tjetrën, i bën bashkë një lidhje e rastësishme më shumë se sa një rrjedhë kronologjike. E kisha provuar diçka të tillë edhe më parë, ndaj mendova ta ripërdorja për të vendosur përfundimisht nëse do ta bëja timen këtë tip rrëfimi apo do ta hidhja tej”, thekson shkrimtari amerikan. E ndërsa pyetet nëse ky roman i rrallë i rrëfimeve seksuale mund të jetë krijuar vetëm duke pasur parasysh shtypsin letrar, Roth përgjigjet: “Jo. Por koncepti nuk është asgjë krahasuar me realizmin. Sipas pikëpamjes sime, përdërisa idetë e mia mbi seksin, fajin, femijërinë, mbi burrat hebrej e gratë e tyre të sjellshme, nuk janë formësuar në një strategji apo në një mënyrë rrëfimi, këto ide nuk ndryshonin aspak nga ato të shumë njerëzve të tjerë. Të gjithë kanë ‘ide’ për një roman: kryeqyteti është i mbushur me njerëz që e kanë kokën plot ide për një roman, por që nuk janë në gjendje as të nisin ta shkruajnë. Shpesh, unë jam një prej tyre”. Tashmë ai është një nga shkrimtarët amerikanë të gjeneratës së tij më të vlerësuar. Është vlerësuar dy herë me Çmimin Kombëtar të Kritikëve, tre herë me “PEN/Faulkner Award”, ka marrë çmimin “Pulitzer” në vitin 1997, pak muaj më parë mori çmimin “Princi i Asturias në Letërsi” dhe së fundmi emri i tij qarkullon në listën e favoritëve për çmimin “Nobel”. Roth është rebeluar shpesh ndaj faktit që atë sot e cilësojnë si shkrimtari më i mirë hebrej që është gjallë. “Kjo gjë më inatos jashtë mase. Do të doja të më konsideronin si një prej shkrimtarëve më të mirë amerikanë në gjallje”, ka thënë ai në një prej intervistave të tij të shkurtër. Ndërkohë, romani “Ankimi i Portnoit” është përfshirë si një ndër 100 librat më të mirë të shek XX.



Sonte, premiera e shfaqjes “Vdekja e Dantonit”

Sonte në Teatrin e Komedisë në Shkup do të shfaqet premiera e shfaqjes “Vdekja e Dantonit”, së autorit Georg Byhner, realizuar nga Tetari Shqiptar i Shkupit, me regji të Dino Mustafiq.

Në këtë shfaqje do të luajnë luajnë: Refet Abazi, Luran Ahmeti, Gëzim Zherka, Fisnik Zeqiri, Muzbajdin Qamili, Osman Ahmeti, Hamdi Rashidi, Genci Mirzo, Amernis Nokshiqi, Ilir Reçi, Sokol Hajrullai, Asdren Selimi, Besfort Idrizi, Berat Mahmut, Ajshe Useini, Arian Ejupi, Faton Ibrahim, Kujtime Ahmeti, Taulant Destani dhe Orfej Asllanaj. Dramaturgjine shfaqjes e ka bërë Zheljka Udoviçiq Pleshina, skenografinë Dragutin Broz, kostumografinë Ines Golja, muzikën Oliver Josifovski dhe koreografinë Gjergj Prevazi.

Drejtori i Teatrit Shqiptar të Shkupit, Adem Karaga u shpreh i kënaqur që “Vdekja e Dantonit” rikthen në skenë aktorin Refet Abazin dhe krijoi hapësirë për aktorët e rinj të akademive teatrore në Shkup dhe Tetovë.

“Pas ‘Viganeve të Maleve’, shfaqja e parë që vjen si projekt i financuar nga Ministria e Kulturës, është ‘Vdekja e Dantonit’ në regji të Dino Mustafiq. Më gëzon fakti, që pas një pas një periudhe shumë të gjatë, riktheu në skenë aktorin Refet Abazi. Pos rikthimit të Refetit, shfaqja do të sjellë në skenë edhe aktorë të rinj, të papërfshirë në institucione. Kemi një pjesë të konsiderueshme të studentëve, të dy akademive teatrore, Shkupit dhe Tetovës”, tha Karaga në një prononcim për Portalb.mk. (E.H)



Koncert kushtuar Hysen Badivukut

Sihana Badivuku me violinë dhe Derek Han me piano, të martën shfaqën një koncert në Filarmoninë e Maqedonisë. Koncerti iu përkushtua Hysen Badivukut dhe Lit Sien Han.

Në moshën 79 vjeçare Hysen Badivuku ndërroi jetë më 24 maj 2017. Ai ishte një ndër violinistët e parë të Kosovës dhe për një kohë të gjatë ishte pjesëtar i Orkestrës së Filarmonisë së Kosovës.

Badivuku qysh prej fillimit të viteve ‘60

e deri në fillim të viteve ‘90, kur regjimi serb mbylli institucionet, ishte pjesë e Orkestrës Popullore të RTP-së. Për gati një dekadë pasluftës ishte angazhuar në Filarmoninë e Kosovës ku kishte rol të dyfishtë: violinist dhe mbajtës i arkivit. Krahas pjesëmarrjes së tij në Filarmoni, ai gjithashtu ka qenë autor i shumë këngëve të këngëtareve të mëdha, siç është rasti me Shpresa Berishën.

Hysni Badivuku është babai i violinistës së shquar shqiptare, Sihana Badivuku.

Koha, e enjte, 24 maj 2018

SEFER SEFERI RRËFEHET PARA DUELIT ME TAJSON FURY

“Të boksosh në këtë nivel nuk është rastësi. Rruga deri këtu ka qenë e gjatë, me shumë vështirësi, punë e palodhshme, e cila për 26 vite kam ditur të sjellë çdo herë suksese”, thotë në faqen e tij zyrtare ne “Facebook” boksieri 39-vjeçar Sefer Seferi



Sefer "The Real Deal" Seferi
15 hrs · E

Të boksosh në këtë nivel nuk është rastësi, rruga deri këtu ka qenë shumë e gjatë, me shumë vështirësi, punë e palodhshme që për 26 vite stervitje kam ditur të sjellë çdo herë suksese.

Kjo rrugë do të vazhdoj edhe pas ndeshjes me Fury. Gjithmonë i uritur për fitore të reja!

vs Tyson Fury
09.06.2018/ Manchester Arena
ENGLAND
Live në Bt Sport



I URITUR PËR FITORE

Më datën 9 qershor, ish-kampioni i botës në peshat e rënda në boks Tajson Fury, do të rikthehet në ring pas 2 vitesh e gjysmë pushim. Në Manchester Arena, britaniku do të duelojë ndaj shqiptarit Sefer Seferi, që ka shansin e artë të duelojë ndaj një kampioni të pam-

poshtur bote edhe pse tashmë Fury nuk i ka më titujt që pat fituar ndaj Vladimir Klitçko. Për shumë fansa e specialistë kjo sfidë konsiderohet e lehtë për Fury, 25 fitore e asnjë humbje si profesionist, por nuk është i këtij mendimi Seferi, 23 fitore e vetëm 1 humbje në karrierë.

Shqiptari premton betejë. “Të boksosh në këtë nivel nuk është rastësi. Rruga deri këtu ka qenë e gjatë, me shumë vështirësi, punë e palodhshme, e cila për 26 vite kam ditur të sjellë çdo herë suksese”, thotë në faqen e tij zyrtare ne “Facebook” boksieri 39-vjeçar Sefer Seferi. Bok-

sieri kuqezi shpreson të fitojë, duke deklaruar se është gati për këtë sfidë: “Gjithmonë i uritur për fitore të reja. Kjo rrugë do të vazhdojë edhe pas ndeshjes me Fury”, deklaron boksieri Seferi, që duelon ndaj një rivali 10 vjet më të ri se ai në moshë, siç është Tajson Fury.

Çeshmexhiev, përforcimi i parë i Shkëndijës?

Shkup, 23 maj - Rezentuesi i shpresave të Maqedonisë, Kostadin Çeshmexhiev është larguar nga skuadra e Akademija Pandev dhe karrierën e tij futbollistike do ta vazhdojë te skuadra tetovare Shkëndija, bën të ditur “gol.mk”, transmeton gazeta KOHA. Drejtuesit e kampionit të ri të Maqedonisë me këtë fillojnë të përforcojnë skuadrën në prag të ndeshjeve kualifikuese në Ligën e kampionëve. Ndryshe, mbrojtësi i talentuar nuk e ka rinovuar kontratën me skuadrën e Akademija Pandev me çka pritet të zyrtarizojë kalimin e tij në Tetovë, ndërsa prezantimin në fanelën e Shkëndijës pritet ta ketë të premtën. Ndërkohë, këtë sezon, 22 vjeçari në fanelën e Akademija Pandev shënoi tre gola, ndërsa gjatë karrierës së tij ka luajtur edhe për Macedonia Gj.P dhe Pelisterin.



Belma me Vurm Mitte plasohet në Bundesliga 3



Shkup, 23 maj - Kur iku nga Kosova, disa thanë se mori fund puna e saj. Sepse disa parashikoni se po i vjen fundi cilësisë së saj. Është fjala për shqiptaren nga Gostivari, hendbollistja Belma Beba, që nga Kastrioti i Ferizajt shkojë në Prishtinë dhe pastaj në Gjermani, në ekipin “HSG Würm-Mitte”. Por, Beba sa ishte në Kosovë kudo që veshi fanelën edhe fitonte trofe! Bum në Kosovë, bum në Gjermani dhe

vazhdimisht është në vëmendje të dashamirëve të këtij sporti. E para, me HSG Würm-Mitte janë ngritur në Bundesliga III dhe Belma premton më shumë se 100 përqindëshin. Parashikimet e disave nuk dolën të sakta, Belma ka 28 vjet dhe është në ritmin e lartë. Treguesi më i mirë janë 147 gola të shënuara për 23 ndeshje nga gjithsej 26-të, duke dëshmuar super cilësitë e saja.

PASI ZVICRA E LA JASHTË LISTËS

Shallandes dhe Kosova vazhdojnë ta kërkojnë Hadërgjonajn



Bernard Shallandes, kur ishte emëruar seleksionues i Kosovës kishte pohuar se lojtarëve që kanë luajtur për Zvicrën dhe që kanë të drejtë loje për Kosovën do tu preferojë që të luajnë për Kosovën. Për ekipin e tij, siç kishte thënë trajneri veteran. Testi i tij i parë i madh është pikërisht një lojtar të cilin Zvicra e la jashtë listës së gjerë për Botërorin Rusia 2018 dhe i cili në kombëtaren e Kosovës mund të jetë startues dhe shumë i rëndësishëm. Në fakt Federata e Futbollit të Ko-

sovës vazhdimisht është duke bërë përpjekje për të siguruar shërbimet e mbrojtësit shqiptar Florent Hadërgjonaj. Hadërgjonaj sivjet ka luajtur për ekipin Haddersfeld në Premier Ligë dhe ka luajtur në 23 ndeshje të ligës dhe 3 ndeshje të Kupës FA. Pas publikimit të listës nga selektori i Zvicrës Vladimir Petkoviç, mungesa e Hadërgjonajt në listë nuk ka provokuar shumë reagime në Zvicër, duke lënë të nënkuptohet se në repartin e mbrojtjes, konkurrenca është shumë e

madhe dhe gjasat e Hadërgjonajt që të mbërrijë të stabilizohet në ekipin e parë në Zvicër, janë të vogla. Shallandes, siç merr vesh “InSPORTi” e ka në radar Hadërgjonajn, por ai nuk ka dhënë përgjigje nëse do të bashkohet Kosovës. Sidoqoftë, fjala është për një futbollist 24 vjeçar, i cili për kombëtaren mund të jetë shumë i rëndësishëm dhe i përdorshëm. Zvicra sivjet do të luajë në botëror për herë të katërt me radhë dhe për herë të pestë që nga viti 1994.



Rossi: Podiumi rezultat i rëndësishëm

Valentino Rossi është rikthyer në podium, duke u renditur i treti në garën e zhvilluar në La Mansh, një rezultat inkurajues për pilotin italian të Jamaha. Një paraqitje e mirë e veteranit, sidomos në pjesën e dytë të garës, duke arritur të klasifikohet i treti. "Pas provave zyrtare isha pesimist, u rendita i nënti, por gara shkoi më mirë. Punuam shumë gjatë natës dhe para garës për të bërë modifikimet e duhura. Jam i kënaqur pasi gjithnjë isha mes më të mirëve. Ky rezultat është i rëndësishëm, pasi vjen në një moment të vështirë për ne, një shtysë për të punuar e vijuar në këtë rrugë", tha Rossi. Piloti italian mendon se Jamaha ka ende shumë potencial për të shprehur në pistë dhe shpreson që në pjesën e dytë të këtij sezoni të fitojë. "Për momentin ky është potenciali ynë, por mund të përmirësohemi. Ndaj ky podium është i rëndësishëm, pasi në këtë pistë gjithnjë jemi paraqitur mirë. Disa pilotë u rrëzuan dhe kjo na ndihmoi në fund, por i rëndësishëm është vendi i tretë. Botërori bëhet gjithnjë e më i vështirë, ndaj nëse duam të jemi kompetitivë duhet të bëjmë gjithnjë nga një hap përpara. Jamaha nuk fiton prej një viti, ndaj duhet të rikthehemi aty ku na takon", u shpreh Rossi.

FIA HEQ "FLAMURIN BLU" NË GARA



Parakalimet bëhen më të vështira

Pilotët që duelojnë për fitoren dhe që janë një xhiro përpara pilotëve më të avashtë, gjithnjë kanë pasur avantazhin e një parakalimi të lehtë, pasi flamujt blu që valëvitin komisarët e pistës sinjalizojnë hapjen e krahut nga ta që janë një xhiro pas. Por Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit pritet ta modifikojë këtë rregull,

madje ta heqë atë, çka do të thotë që pilotët e avashtë nuk janë të detyruar më të hapin krahun edhe pse janë një apo më shumë xhiro pas pilotët që vjen pas tyre. Ky modifikim i rregullores pritet ta bëjë më të bukur garën, pasi pilotët që pretendojnë për fitore, mund të vuajnë mjaft për të bërë këto parakalime "të lehta", duke humbur

mjaft kohë pas makinave më të avashta në pistë. "Ky ndryshim është propozuar disa herë, por nuk ka gjetur mbështetje. Gjithsesi, ne e kemi vlerësuar si të kotë këtë rregull, ndaj po mendojmë për ta hequr atë në të ardhmen, për t'i bërë garat më tërheqëse dhe parakalimet më të vështira", tha Çarli Uthing, drejtori i garave të Formula 1.

"ROLAND GARROS" KUNDËR SERENA UILLIAMS

FTESË, POR JO GARANCI PËR SHORT TË LEHTË

Rikthimi në fushë i tenistes amerikane Serena Uilliams në grand slem-in e "Roland Garros" bëhet i vështirë, pasi organizatorët kanë deklaruar se nuk do ta vendosin ish-numrin 1 në botë në grupin e tenisteve kryesore. Duke qenë se motra e vogël Uilliams është në vendin e 453-të, ajo mund

të përballlet me këdo në këtë turne që në raundin e parë, përfshi edhe numrin 1 në botë Simona Halep. Tenistja mund të rikthehet pa probleme në këtë turne, si me ftesë ashtu dhe me faktin se vjen nga shtatëzania dhe ka të drejtë të duelojë, por kjo situatë nuk do ta "mbronte" atë nga shorti. Edhe pse

Federata Ndërkombëtare ka deklaruar disa herë se pritet të ndryshojë këtë rregull për tenistet që vijnë nga shtatëzania, që në short të kenë pozicionin që kanë pasur më parë, për këtë vit ky ndryshim nuk do të ndodhë. Çka do të thotë që aventura e Serena Williams në turneun parisien mund të zgjasë pak në rast se

Edhe pse Federata Ndërkombëtare ka deklaruar disa herë se pritet të ndryshojë këtë rregull për tenistet që vijnë nga shtatëzania, që në short të kenë pozicionin që kanë pasur më parë, për këtë vit ky ndryshim nuk do të ndodhë. Çka do të thotë që aventura e Serena Williams në turneun parisien mund të zgjasë pak në rast se përballlet me një nga tenistet e vendeve të para që në start dhe mund të eliminohet shumë shpejt

pak në rast se përballlet me një nga tenistet e vendeve të para që në start dhe mund të eliminohet shumë shpejt. Kjo situatë mund të detyrojë tenisten amerikane që të mos duelojë në këtë turne, pasi ky është turneu i parë që luan pas dy muajsh pushim, i pari në fushat me dhë.

Hjuston barazon serinë e finaleve



NBA – KONFERENCA E LINDJES (FINALE PLEJ-OF)

Boston S. – Klivlend K. (2-2 me ndeshje)

NBA – KONFERENCA E PERËNDIMIT (FINALE PLEJ-OF)

Hjuston – Golden S. 95-92 (2-2 me ndeshje)

Hjuston ka barazuar 2-2 serinë e finaleve të plej of-it në Konferencën e Perëndimit, pas fitores 95-92 ndaj Golden Stejt Uarriors, ndeshje e luajtur në fushën e këtij të fundit. Një ndeshje e ekuilibruar dhe me rivalitet, të dyja ekipet e kërkuar fitoren, ku herë udhëhiqte njëri ekip e herë tjetri. 5 minutat e fundit të takimit folën për miqtë

e Hjuston, që triumfuan falë 30 pikëve të Harden dhe 27 të Paul, duke bërë diferencën në parket. Në kahun tjetër, Kurry realizoi 28 pikë dhe Durant 27 pikë e 12 kërcime, por që s'mjaftuan për të evituar këtë humbje, disi e papritur për Uarriors, që zhgënjeu para fansave të tij. Tashmë seria e finaleve do të spostohet në fushën e Hjuston.

Mejveder më i famshëm se MekGregor

Sportisti i arteve marciale mikse Konor MekGregor ka humbur një tjetër duel me ish-boksierin Flojd Mejveder, por këtë herë jo në ring. Televizioni "ESPN" ka publikuar një renditje të sportistëve që kanë më shumë popullaritet në botë, bazuar në kërkimet në internet, të ardhurat e tyre si dhe ndjekësit që ata kanë në rrjetet sociale, duke përcaktuar 100 sportistët më të suksesshëm dhe të kërkuar. Në krye

të kësaj liste ndodhet futbollisti portugez Cristiano Ronaldo, ndjekur nga basketbollisti LeBron Xhejms futbollisti tjetër Lionel Messi. Në vendin e 14-të ndodhet ish-boksieri Flojd Mejveder, që ka lënë me 4 pozicione më pas irlandezin Konor MekGregor. Sportisti i MMA-së ka më shumë ndjekës në rrjetet sociale se boksieri amerikan, por ky i fundit ka më shumë klikime dhe më shumë të ardhura.



ARSEN VENGER ZBULON SEKRETET

"Ju gjithmonë jeni të tunduar të shkoni në stolin e Real Madridit, ndërsa mua më ofruan mundësinë për të marrë kontrollin e të gjithë klubit. Në fund të ditës u thashë "jo" një herë, dy herë. Kam refuzuar kaq shumë klube, sa ju nuk mund ta besoni. Në fund të ditës, isha i lumtur që mbeta unë", pohon Wenger



REALIN E ANGLINË I KAM REFUZUAR DY OSE TRE HERË

Arsen Wenger ka zbuluar se ka hedhur poshtë dy oferta të Real Madridit, si dhe ka refuzuar dy, ose tri herë drejtimin e Anglisë, gjatë mbretërimit të tij 22-vjeçar tek Arsenalit. Trajneri i njohur francez është duke u përgatitur për një sfidë të re, pasi ka rënë dakord për përfundimin e hershëm të një kontrate dyvjeçare në stadiumin "Emirates", të nënshkruar verën e vitit 2017. Mbetet të shihet se çfarë do të bëjë më pas, me 68-vjeçarin që synon të mbetet në futboll, por përjashton një rol në një klub tjetër anglez, pas qëndrimit të gjatë në veri të Londrës. Ai mund të kishte shkuar në "kullota" të reja shumë kohë më parë, nëse do t'i kishte marrë parasysh ofertat e shumta.

Wenger i tregoi "beIN Sports" për lidhjet me gjigantët e La Ligas, Real Madridin, i cili e ndoqi atë për vite me radhë: "Real Madridi? E kam refuzuar dy, ose tri herë. Është një nga ekipet që e kam dashur kur isha fëmijë. Unë thjesht mendova se ishte një periudhë shumë e ndjeshme për Arsenalin. Ju gjithmonë jeni të tunduar të shkoni në stolin e Real Madridit, ndërsa mua më ofruan mundësinë për të marrë kontrollin e të gjithë klubit. Në fund të ditës u thashë "jo" një herë, dy herë. Kam refuzuar kaq shumë klube, sa ju nuk mund ta besoni. Në fund të ditës, isha i lumtur që mbeta unë", shprehet Wenger. Me synimin për të transformuar kombëtaren angleze, me qasjen e tij ndaj menaxhimit, Wenger u kërkua, gjithashtu,

nga federata Angleze e Futbollit gjatë kohës së tij në stolin e Arsenalit. Megjithatë, francezi pati të njëjtin reagim, si ndaj Real Madridit, sa herë tentuan ta joshnin. Wenger tregoi përpjekjet e Anglisë për ta emëruar atë, derisa dera i ishte lënë e hapur për një rol të ardhshëm me "Tre Luanët". "E refuzova dy, ose tri herë Anglinë. Por, në atë kohë, angazhimi i përditshëm për mua ishte i rëndësishëm. Unë e kam thënë shumë herë se duhet të jetë një djalë anglez, që merr drejtimin e ekipit kombëtar të Anglisë. Është një vend i madh futbollit, që ka mjaftueshëm trajnerë të kualitetit të lartë, ndaj mendova se ndoshta nuk ishte e drejtë për mua, ta bëja këtë", deklaroi tani më ish-trajneri i Arsenalit, Arsen Wenger.

FIRMOS PËR TRE SEZONE

Arsenali zyrtarizon trajnerin Emery



Unai Emery është zyrtarisht trajneri i ri i skuadrës së Arsenalit. Ka qenë vetë klubi londinez që njoftoi nëpërmjet një njoftimi në faqen zyrtare emërimin e spanjollit në krye të "Topçinjve". Emery ka nënshkruar për tre vite dhe do të përfitojë të paktën 15 milionë ster-

lina në total. "Jam shumë i emocionuar që iu bashkova një klubi të madh. Arsenalit njihet dhe dashurohet në të gjithë botën për stilin e lojës, menaxhimin e talentëve të futbollit, stadiumin fantastik dhe vazhdimësinë e klubit", – ishin fjalët e para të spanjollit. "Jam i emocionuar për mundësinë që po më jepet për një hapur një kapitull të ri në historinë e Arsenalit. Jam takuar me Stan dhe Josh Kroenke dhe është e qartë se ata kanë ambicie të mëdha", deklaroi tani më trajneri i ri i Arsenalit, Unai Emery. Unai Emery e ka nisur karrierën e trajnerit te Deportivo Lorca në vitin 2005, teksa si futbollist është aktivizuar përgjithësisht në "Segunda Division". Gjatë karrierës së trajnerit ka drejtuar Almerian, Valencian, Spartakun e Moskës e më pas Sevilyën dhe së fundmi PSZH-në.



Çells-Konte, "divorci" është çështje orësh

E ardhmja e Antonio Kontes është në fije të perit. Shkarkimi i tij nga Çellsit duket thjesht një formalitet dhe zyrtarizimi mund të vijë në orët e ardhshme. Problemi i vetëm që ka mbetur është vetëm prishja e kontratës. Konte dhe Çellsit janë të lidhur nga një klauzolë e dyfishtë që vlen si për klubin londinez ashtu edhe për trajnerin italian, kështu palët po diskutojnë. Çellsit dëshiron ta largojë, ndërsa Konte nuk ka ndërmend të heq dorë nga viti i fundit të kontratës. Ish-trajneri i Italisë nuk ka hyrë kurrë në zemrën e pronarit Roman Abramoviç, edhe pse Konte ka fituar Premier Ligën në sezonin e kaluar dhe "FA Cup" në këtë sezon, ku pas finales së fituar ndaj Manchester Junajtedit, Antonio tha se ishte një fitues i lindur. Shtypi anglez ka shkruar se Abramoviç ka vendosur largimin e Kontes dhe njerëzit e tij kanë gjetur marrëveshje me pasardhësin Luis Enrique, mbetet vetëm për t'u prishur kontrata me Konten. Emrat e tjerë që mund të punojnë në "Stamford Bridge" janë Slavisa Jokanoviç i Fulham dhe Morris, trajneri i Çellsit U-19.

LAJME SHKURT

Leverkusen siguron talentin Paulinjo

Bajer Leverkusen më në fund ka arritur të sigurojë shërbimet e një prej talentëve më premtues të futbollit brazilian. Paulo Henrique Sampaio Filho, i njohur shkurt me emrin Paulinjo, do të jetë pjesë e klubit nga Bundesliga që nga sezonin e ardhshëm. Sulmuesi 17-vjeçar i Vasko Da Gamas pritet të ndjekë gjurmët e emrave të rëndësishëm brazilianë, që kanë qenë pjesë e "Aspirinave" në të shkuarën, si Ze Roberto, Lusio, Emerson e së fundmi Vendell. Sipas mediave gjermane, Leverkusen duke përfutur edhe nga problemet financiare të klubit brazilian do të paguajë 20 milionë euro për kartonin e futbollistit, 10 më pak se klauzola e largimit.

Inzagi kandidat për trajner i Bolonjës

Me Roberto Donadonin gjithmonë e më larg stolit të Bolonjës, për shkak të marrëdhënieve jo të mira me tifozët, klubi ka nisur nga puna për afrimin e një tjetër trajneri për sezonin e ardhshëm. Sipas mediave italiane, Pippo Inzagi, i cili aktualisht drejton Venecian, ka tërhequr vëmendjen e shumë ekipeve të tjera, përfshi këtu edhe Bolonjën, me drejtuesit e kuqbluve që e shikojnë ish-milanistin si alternativa e duhur për të drejtuar ekipin. Gjithsesi duhet pritur përfundimi i fazës plej-of të Serisë B, ku Venecia e Inzagit do të përballlet me Perugjën për të mësuar të ardhmen e trajnerit. Pavarësisht kësaj, klubi po shqyrton edhe alternativa të tjera si Nikola, De Zerbi e Stroppa.

Juventusit parakalon Interin dhe Romën

Sipas mediave italiane, Juventusit ka arritur të mposhtë konkurrencën e Interit dhe Romës sa i takon belgut Dennis Praet, i cili me shumë mundësi do të transferohet te bardhezinjtë gjatë merkatos së verës. Në tratativën e nisur, për 24-vjeçarin me drejtuesit e Sampdorias, "Zonja e Vjetër" është gati të përfshijë edhe kartonin e mesfushorit 20-vjeçar, Rolando Mandragora, i cili sezonin që sapo u mbyll u aktivizua në formë huazimi te skuadra e Krotones.

Badelj ende nuk ka rinovuar me Fiorentinën

E ardhmja e Milan Badelj vazhdon të mbetet në pikëpyetje te Fiorentina. Mesfushori është në fund të kontratës me klubin vjollcë dhe nuk ka vendosur ende nëse do të pranojë ofertën për rinovimin e kontratës. Për kroatin ka kohë që interesohet Milani, që e shikon futbollistin si përfundim të duhur për reparitin e mesit të fushës për sezonin e ardhshëm. Menaxheri i klubit vjollcë, Xhankarlo Antonognoni, deklaroi se drejtuesit do të bëjnë maksimumin që kroatit të qëndrojë në Firence, pasi konsiderohet një lojtar i rëndësishëm për të ardhmen e skuadrës.

Duke nisur nga titulli i Veronas në 1985, arbitrat nuk zgjidheshin rëndom për ndeshjet. Ata zgjidheshin specifikisht, diçka që çoi te "Calciopoli" i famshëm që fundosi futbollin italian në vitin 2006. Telefonatat e përgjuara zbuluan një rrjetë marrëdhëniesh mes klubeve dhe arbitrave, ku ekipet më të mëdha zgjidhnin me gisht arbitrat e preferuar për ndeshje të caktuara dhe u shpallën fajtorë për trukime ndeshjesh

Ka qenë një kohë kur tifozët britanikë nuk i kishin në stadiumet e tyre yjet e futbollit. Përpara ditëve të internetit, e vetmja mënyrë për të parë super yjet më të mëdhenj të futbollit evropian ishte në Serie A. Dhe ka pasur një periudhë kur kampionati italian transmetohej nga çdo kanal i mundshëm shqiptar... Në vitet e para të ngjizjes së Premier Ligës, Italia ishte vatra e talenteve, me yjet më të mëdhenj të futbollit që shkëlqenin në vendin mesdhetar. Përveç talenteve më të mirë, skuadrat italiane kishin edhe fanellat më të bukura: nga viola e Fiorentinas, te e verdha me blu e famshme e Parmas, e kuqja me të verdhë e Roma-s dhe fanella blu e Sampdorias e shoqëruar me të bardhë. Le t'i hedhim një sy së shkuarës, në vitet kur Serie A dominonte botën, dhe sesi u fundos tragjikisht. Në vitin 1992, futbollit anglez iu nënshtrua një transformimi kolosal me lindjen e Premier Ligës. Por në të njëjtën kohë, ikonat

JA SI "CALCIOPOLI" I DHA FUND KOHËS SË ARTË TË SERIE A



e "Tre Luanëve" po largoheshin nga brigjet britanike, teksa Pol Gaskoin u transferua te Lacio—dhe që nga ai moment, filloi "Football Italia", emisioni i "Channel 4" anglez. Për shumë shtete me emër në futboll, si Gjermania apo Italia, televizori ishte i vetmi vend ku mund të shihje ikonat që nuk do të luanin ndonjëherë në Premier Ligë apo Bundesliga. Futbollit italian kishte kohë që dominonte si brenda, ashtu edhe jashtë fushës përpara vitit 1992, madje klubet italiane thyen rekordin e transferimeve gjashtë herë në tetë vitet e fundit.

Nga viti 1989 deri në vitin 1999, kishte një skuadër italiane në fina-

len Kupën e Evropës/Çampions Ligë. Teksa ata ishin akoma më dominues në Kupën e UEFA, duke prodhuar tetë fitues në 11 vite gjatë së njëjtës periudhë, si dhe gjashtë finalistë humbës. Për më tepër, tetë çmime "Ballon d'Or" iu dhanë yjeve të Serie A në ato 11 vite. Kishte një fabrikë të pafundme talentesh, teksa lojtarët më të mirë nuk luanin vetëm me ekipet më të mira: nga viti 1984 deri në vitin 2000, pesë klube të ndryshëm italianë thyen rekordin e transferimeve.

Një skuadër të Premier Ligës do t'i duhej 11 vite për të paguar 40 milionë eurot që Lacio pagoi për të blerë Hernan Krespon nga Parma

në vitin 2000. Futbollit italian kishte arritur një nivel fuqie që nuk ishte parë ndonjëherë. Ishte një periudhë ku Interi mund t'i bënte presion Barcelonas për të blerë Ronaldon, dhe theu barrierën e 35 milionëve duke blerë Kristian Vierin megjithëse nuk ishte në gjendje t'i ofronte futboll Evropian.

Fiorentina ra nga kategoria në vitin 1993, por arriti ta mbante Gabriel Batistutan, megjithëse kishte interes nga klubet më të mëdha botërore. Futbollit italian dukej i paprekshëm, me pronarë të kamur që nuk nguronin të investonin shuma marramendëse për të pasur sukses në kampionatin më të madh të hi-

storisë. Gjithsesi, ai u shkatërrua në mënyrë të shëmtuar disa vite më pas.

Duke nisur nga titulli i Veronas në 1985, arbitrat nuk zgjidheshin rëndom për ndeshjet. Ata zgjidheshin specifikisht, diçka që çoi te "Calciopoli" i famshëm që fundosi futbollin italian në vitin 2006. Telefonatat e përgjuara zbuluan një rrjetë marrëdhëniesh mes klubeve dhe arbitrave, ku ekipet më të mëdha zgjidhnin me gisht arbitrat e preferuar për ndeshje të caktuara dhe u shpallën fajtorë për trukime ndeshjesh. Pasojat ishin katastrofike për futbollin italian, me Juventusin që kishte qenë kampion në dy sezonin e fundit, duke përfunduar në Serie B me dy tituj të hequr. Ndërkohë, AC Milan, Fiorentina dhe Lacio gjithashtu ishin pjesë e skandalit dhe iu hoqën pikë për sezonin e ardhshëm. Interi ishte fituesi i madh teksa i mori rivalëve lojtarët më të mirë, por nuk arriti të mbante lart futbollin italian megjithëse fitoi tripletën në 2010, dhe vetëm gjashtë vite më pas Serie A humbi një vend në Çampions Ligë. Për dhjetë sezonet e ardhshëm pas skandalit, kishte vetëm dy fitues. Gjithsesi, dy finalët në tre vitet e fundit të Joves në "Champions League" i kanë dhënë shpresë Serie A. Por, ditët kur Parma, Sampdoria, Napoli dhe Torino ishin pjesëmarrës të rregullt të kupave evropiane duken të largëta.

Argjentina pa portierin titullar në Rusi

Argjentina ka njoftuar se portieri Sergio Romero nuk do të jetë në gjendje të luajë në Kupën e Botës së Rusisë për shkak të lëndimit në gju. Romero pritej të ishte portieri numër një i Argjentinës për Kupën e Botës së kësaj vere, por nuk do të jetë në gjendje t'i veshë dorezat për shkak të dëmtimit të fundit. Portieri pritej ta fillonte si titullar për Mançester Junajtedin në finalen e "Fa Cup", por trajneri Hoze Murinjo përzgjedhi David de Gea, për shkak të mungesës së gatishmërisë nga Romero. Dhe 31-vjeçari, i cili luajti në finalen e Kupës së Botës së kaluar, ku Gjermania shënoi një fitore 1-0 ndaj Argjentinës, në vitin 2014, tani do ta humbasë shansin për të përfaqësuar vendin e tij në Rusi. Lista përfundimtare me 23 lojtarë e Argjentinës për Botërorin e kësaj vere u zyrtarizua të martën, me ka-



pitenin e Interit, Mauro Ikardi, i lënë jashtë nga trajneri Jorge Sampaoli. Argjentina, e cila konfirmoi se Romero kërkon ndërhyrje kirurgjikale në gjurin e tij të djathtë, tashmë ka konfirmuar se Nahuel Guzman, nga skuadra e Liga Tigrës, do ta zëvendësojë Romeron në ekip.

SHËNON MË SHUMË SE MESSI, RONALDO DHE SALAH Jonas mbetet jashtë Botërorit

Çfarë bën zakonisht një qendërsulmues? Shënon gola. Po një qendërsulmues brazilian? Prej disa vitesh ky nuk është kriteri kryesor. Jemi mësuar me futbollistët e "Selecao" që shënojnë një "mal" me gola, por në vitet e fundit brazilianët janë treguar sulmues që veprojnë më shumë jashtë zonës dhe merren me ndërtime e golave, jo me shënimin e tyre. Duke harruar plotësisht shkollën që ka pasur emra të tillë si Pele, Ronaldo apo Romario, më të mirët në rolin e tyre, në Brazil ka nisur një tendencë e re, që ka përfshirë edhe trajnerin e kombëtares Tie, i cili ka preferuar të marrë një sulmues të lëvizshëm si Taison dhe të lërë në shtëpi "të shkretin" Jonas. Por përse sulmuesi i Benfikës duhet të ishte në avionin për në Rusi? Sepse është sulmuesi që ka shënuar më shumë në Evropë, plot 34 gola me "shqiponjat". Shumë gola, edhe më shumë se Leo Messi, Sallah, Kin dhe



Ronaldo, por që këto gola nuk i kanë vlejtur absolutisht asgjë. Kampionatin portugez e fitoi Porto, "Këpucën e Artë" e mori Messi, sepse La Liga kishte koeficient më të lartë se Primera. Tito zgjedhi para tij tre sulmues që sivjet shënuan gjysmën e sasisë së golave dhe që kanë si karakteristikë kryesore hapjen e zonave, krijimin e hapësirave, numra "9" falso si Gabriel Jesus, Firmino dhe Taison. Kësisoj, Brazili nuk do të ketë më një qendërsulmues tipik, dhe

Jonas ishte i vetmi i tillë, teksa Gabriel Jesus niset në avantazh ndaj Firmino për vendin e titullarit. Brazili mbetet favorit për të marrë trofeun në Rusi, ashtu si ndodh në çdo Botëror, por ideja është se 34-vjeçari që shënoi 34 gola meritonte të paktën një mundësi. Nëse do të kishte përdorur pasaportën e dytë, atë portugeze, padyshim që do të ishte në botëror, por ai u përballë me idenë e re që qarkullon në Brazil: në futboll nuk ka më "pykë"



DASHI 21. mars - 20. prill

Do bëni çmos që ta ruani qëndrueshmërinë dhe harmoninë në jetën tuaj në çift gjatë kësaj dite. Edhe partneri, pavarësisht se nuk do ketë shume kohe të lire, do mundohet t'ua beje qejfin. Beqaret do kenë takimin që aq shume kane pritur dhe do ndihen me se miri. Financat do jene te mira, kështu që mund te kryeni investimet që keni menduar prej kohesh.



DEMI 21. prill - 21. maj

Planetët nuk do kenë ndikim shume te madh gjatë kësaj dite ne jetën tuaj ne muft, prandaj ju mund te bëni atë që dëshiro- ni ne mënyrë që ambienti te ngrohet me tepër. Beqaret do mbështeten gjithë kohës nga Marsi dhe do e takojnë personin e ëndrrave. Rrethanat do jene te përshtatshme edhe për te përmirësuar buxhetin. Do jeni shume te zotet ne këtë fushe.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Dita e sotme do jete e mire për te dashuruarit edhe pse pasioni nuk do jete aq i zjarrte sa mendohej. Përfitoni për te folur me partnerin mbi te ardhmen. Beqaret do kenë shume sukses ne dashuri dhe do e gjejnë personin që do iu përshtatet me se miri. Ne planin financiar do arrini te kryeni investimet e duhura dhe situata do jete serish jo problematike.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Një klime goxha e ngrohte do mbizotërojë gjatë kësaj dite ne jetën tuaj sentimentale. Do e keni me te lehte te flisni lirisht me partnerin dhe do i shprehni ndjenjat që para disa kohesh nuk keni mundur. Beqaret duhet te presin edhe disa dite për te gjetur dashurinë e madh. Financat nuk do jene ne gjendjen me te mire, prandaj bëni mire te kujdeseni me shume për shpenzimet.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Dite e mbushur me surpriza te shumta kjo e sotmja për ata që janë ne një lidhje. Shfrytëzojeni ditën deri ne sekondën e fundit dhe pranoni te bëni ndonjë çmenduri te vogël. Beqaret do kenë dashuri me shikim te pare dhe me ne fund do i japin fund vetmisë. Situata financiare do jete e favorshme edhe për te kryer ndenje shpenzim me tepër.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjatë kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushë mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica që te ruani një situatë te qëndrueshme.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

As mos e mendoni ta tradhtoni partnerin tuaj gjatë kësaj dite sepse reagimi i tij nuk do iu pëlqejë aspak. Nëse nuk e doni me mire ja shprehni drejtpërdrejt. Beqaret do kenë takime te ndryshme, por asnjeri nuk do ua mbushë mendjen aq sa për te krijuar një lidhje. Ne planin financiar duhet te bëni shume sakrifica që te ruani një situatë te qëndrueshme.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kujdes me xhelozinë e tepruar gjatë kësaj dite sepse mund te keni probleme serioze me partnerin. Mos kërkoni ta detyroni atë te qëndrojë vetëm pranë jush, por lëreni te dale edhe me miqtë e ngushte. Beqaret do vazhdojnë te jene ne kërkim, por nuk do e gjejnë personin e duhur. Financat do jene ne gjendje shume me te mire nga sa mendohej.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do jeni shume kërkues ndaj partnerit tuaj sot dhe nuk do kënaqeni me aq sa ai do iu japë. Mendohuni njëherë se sa i keni dhënë ju atij. Beqaret nuk duhet te pranojnë asnjë takim për sot sepse personat që do ua kërkojnë këtë nuk do jene te përshtatshëm për ta. Ne planin financiar do iu pushtojte optimizmi. Pak nga pak do filloni ta përmirësoni buxhetin.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Dite shume e zakonshme dhe pa asgjë te veçante kjo dite për ata që janë ne një lidhje. Do vazhdoni ta jetoni jetën ashtu si t'iu vije. Beqaret do kenë një dite te mbushur me takime dhe emocione. Do argëtoheni pa fund me personat që do njihni. Ne planin financiar mos dëgjoni këshillat e te tjerëve, por veproni ashtu si ju mendoni ne mënyrë që te përmirësoni këtë sektor.



UJORI 21. janar - 19. shkurt

Nëse partneri juaj tregohet i rrepte me ju dhe e tepron me ngritjen e zërit tregojani menjëherë vendim, mos prisni që situata te ndërlikohet edhe me shume. Beqaret me shume gjasa do nisin një histori dashurie te sinqerte dhe te bukur. Situata financiare do jete shqetësuese, prandaj do iu duhet te merrni disa masa strikte ne këtë plan.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Nëse kohet e fundit marrëdhënia me partnerin ishte ftohur paksa, sot gjithçka do marre një tjetër drejtim. Do flisni hapur dhe do sqaroni çdo keqkuptim që keni pasur. Për beqaret nuk ehte momenti i duhur për te filluar angazhime serioze. Prisni edhe pak kohe me tepër. Perspektivat financiare janë goxha te mira. Do shpenzoni aq sa doni dhe serish buxheti do jete i mire.

GJIHË QË FLASIN MBI 400 POPËJ NË AFRIKË	B	NDËRPPRES, NDALOU	TEMË E NDALUAR	ILIRIANA SULKUQI	MEN IN BLACK	IMPULSI	NJË SHFLETUES I INTERNETIT	EMRI I VËRTETË I KËNGËTARIT NË FOTO	NATO (FRENGJ.)	EMRI ARTISTIK I KËNGËTARIT NË FOTO
LËNDË KUNDER MIKROBEVE										
SHKËPUTJE E DY PALEVE, PERÇARJE						LOJ LETRE SHTYPI				
TABULATOR				DRU I MADH AFRIKAN						
VENDLINDJA E KËNGËTARIT NË FOTO				TEMPERATURA						
D					E LUAJ NGA MENDTË					



ISH BOKSIERI AMERIKAN, LARI	H	KALTËR (GJERM.)	FUTBOLLISTI GJERMAN, MIROSLAV	K	ZBARDHJE DITE					
CMIMI QË E FITOI KËNG. NË FOTO MË 2016			SPANJA			AQ SA DUHET, NE RREGULL				
N						ISH TENISTI AMERIKAN, SAMPRAS				
LUTFI LEPAJA			KUNDËRSHTAR							
			KUNA KROATE							
STADIUMI I RUEKES									OKSIGJENI	
									AUSTRIA	
VEPRA E PROFETIT MUHAMED								AUTORI GJERMAN, TOMAS		

UEM, RN, K, ACAR, H, K, AGIME, NOBEL, TAMAM, LL, Oponent, MAKSIMIR, O, SUNETI, MAN, ZGJIDHJET-B, ANTI MIKROB, NDASI, ROTO, TAB, BAOBAB, DULUT, ÇMEND, IR, I, BUTIL, MAMA, LAN,

shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

3					8			9							1
	8							2						9	
		7	1	5	3	6								8	4
	3			8				7							
			4		1										1
7				9						9	3	5	4		
		6	8	1	7	4				7	6			8	3
	7							1			8				9
4					6					2					

Shumë i lehtë: 341268759, 685749321, 927153684, 134682975, 859471263, 762395148, 596817432, 278934516, 413526897. Mesatar: 842359617, 576814923, 391672584, 654128739, 983746251, 217935468, 769581342, 438267195, 125493876.


Policia e shpall të zhdukur në Facebook, i zhdukuri i komenton!

“Ne jemi të shqetësuar në për 21 vjeçar Leon Smith, i cili humbi në lagjen Wheatley në Halifax”, shkroi policia kanadeze e West Yorkshire në Facebook. “I zhdukur! Leon është një mashkull i bardhë me flokë bjonde. Herën e fundit që është parë, ai ishte i veshur me një kostum të zi, një këmbishë blu dhe atlete të zeza”, vijonte postimi. Postimi i policisë në West Yorkshire, Kanada, dukej tamam si raport i një djali të zhdukur. Por Leon Smith, 21 vjeç, ia ktheu: “Unë nuk jam zhdukur, ju po më kërkoni”, nën fotografinë e tij. “Shkoni, bëni punën tuaj”, shtoi ai. Shkëmbimi i komenteve vazhdoi. 21 vjeçari ka shpjeguar se policia ishin në kërkim të tij në vende të frekuentuara zakonisht, por ai



ishite duke u përpjekur për të mbajtur një “profil të ulët” në mënyrë që të mos gjen-dej. Kjo ngjarje ndodhi rreth orës 16:30 të

së dielës. Një orë më vonë djali u arrestua. Ai me të vërtetë kishte kryer një krim, por zyrtarët nuk e thanë se çfarë ishte.



Si të identifikoni shenjat e sulmit në tru

Sulmi në tru është një gjendje tejet e rrezikshme ku ndërpritet qarkullimi i gjakut për shkak të bllokimit apo këputjes së enëve të gjakut. Çdo vit rreth 800 mijë amerikanë vuajnë nga sulmi në tru. Njohja e simptomave të kësaj gjendjeje është shumë e rëndësishme. Por, si ta identifikoni sulmin? Janë disa studime që janë kryer për të identifikuar shpejt nëse është duke ndodhur sulmi. Në vijim janë dy shenja që tregojnë për sulmin:

- Fytyra e personit zakonisht lëshohet me një anë, duket sikur një përpjeke për buzëqeshje. Në shumicën e rasteve vërehet asimetria, sepse njëra pjesë e trupit veçse paralizohet.
- Gjatë sulmit njeriu nuk mund t'i ngritë krahët, pasi njëri nga ta do të bie përsëri poshtë. Sulmi mund të shkaktojë dobësim të përnjëhershëm të imunitetit. Njeriu po ashtu mund të humbë komplet baraspeshën dhe të rrëzohet.

Prindërit me gjykatë e dëbojnë djalin e vetëm nga shtëpia

Një gjykatë në New York ka urdhëruar një 30-vjeçar që të largohet nga shtëpia e prindërve pasi ata me muaj të tërë kanë dështuar ta largojnë vetë. Prindërit kanë tentuar ta dëbojnë nga shtëpia djalin e tyre të vetëm, Michael Rotondo pasi ka refuzuar të kontribuojë në çështjet rreth shtëpisë.


Mark dhe Christina të martën në gjykatë kanë thënë se djali i papunësuar refuzonte të paguante për qëndrimin në shtëpi dhe nuk donte të ndihmonte në punën rreth shtëpisë. Michaeli doli nga gjykata i frustruar dhe ka thënë se nuk e mendoi

që gjykatësi do ta lexonte gjithë procesin gjyqësor, raporton CNY Central. Ai e ka ndërmend të apelojë vendimin. Gjatë tre muajve të fundit, prindërit i kanë shkruar letra për t'u larguar, por ato i ka injoruar djali i tyre. Ata kanë tentuar ta dëbojnë, por kanë mësuar se anëtarët e familjes mund të largohen nga shtëpia vetëm me procedura ligjore.

Si kundërpërgjigje ndaj prindërve, Michaeli që në korrik mbush 31 vjet – ka thënë se prindërit nuk i kanë dhënë arsye për dëbimin e tij ose kohë për të gjetur një shtëpi të re.



Robotët tani rrisin organe njerëzore



A ka ndonjë gjë që robotët nuk mund ta bëjnë? Mund të bëjnë punën tonë, të marrin periudhat e tyre dhe tani... të rrisin organe njerëzore. Shkencëtarët e Uni-

versitetit Mjekësor të Uashingtonit kanë zhvilluar një sistem automatik që përdor robotët për të prodhuar mini-organe njerëzore nga qelizat staminale. Sipas Science Daily, aftësia për të prodhuar në masë “organoidët” ka premisa të zgjerorjës përdorimin e mini-organeve në kërkime bazë dhe zbulim ilaçesh. “Kjo është “arma jonë sekrete” në luftën kundër sëmundjeve”, thotë Benjamin Freedman, shkencëtar në këtë universitet. Më herët, shkencëtarët do të rrisnin qeliza për kërkime biomjekësore, duke i kultivuar ato në fletë të sheshta. Por ishin shumë të thjeshta për të imituar rrugën

e vërtetë të qelizave. Por ky zhvillim i ri jep mundësinë e prodhimit të organoideve me një ritëm të shpejtë. Është hera e parë që shkencëtarët janë të aftë të prodhojnë në masë këto mini-organe nga qelizat staminale. “Zakonisht, vetëm ngritja e një eksperimenti të kësaj madhësie do t'i kërkonte studiuesit gjithë ditën, ndërsa një robot e bën për 20 minuta. Përveç kësaj, roboti nuk lodhet apo të bëjë gabime... Nuk ka pyetje për detyrat e përsëritura dhe të lodhshme, robotët bëjnë një punë më të mirë se njerëzit”, thotë Freedman për Science Daily.

1522 - Perandori Karli I kthehet në Spanjë.

1784 - Hebrejtë dëbohen nga Varshava.

1810 - Argjentina shpall pavarësinë prej Spanjës Napoleonike (Dita Kombëtare).

1812 - Tërmeti shkatërron Karakasën në Venezuelë.

1911 - Revolucioni në Meksikë shkarkohet Kryetari Jose Porfirio Diaz.

1940 - Trupat gjermane pushtojnë Bolonjën.

1944 - Udhëheqësi i partizanëve Tito i ikë rrethimit të Gjermanëve në Bosnjë (Desanti në Dervar).

1946 - Abdullah ibn Hussein shpallet mbret i Jordanisë dhe shteti shpallet i pavarur nga Britania e Madhe.

1949 - Ushtria e kuqe kineze okupon Shangain.

1965 - Fillon konflikti kufitar mes Indisë dhe Pakistanit.

1989 - Mihail Gërbaçov zgjidhet President ekzekutiv i Bashkimit Sovjetik.

1992 - Oscar Luigi Scalfaro zgjidhet President i Italisë.



Bursa e Nju Jorkut për herë të parë që nga themelimi para 226 vjetësh do të ketë një femër në krye të saj. Stacy Cunningham, e cila nisi karrierën si tregtare në bursën e Nju Jorkut dhe aktualisht drejtoreshë e operimit në grupin NYSE, do të jetë presidentja e 67-të e kësaj burse, njoftoi sot Bursa Ndërkombëtare. Kjo do të thotë se gratë do të udhëheqin dy bursat më të famshme në botë.

Adena Friedman u bë drejtoreshë e përgjithshme e bursës Nasdaq në fillim të vitit 2017. Thomas Farley, presidenti aktual i Bursës së Nju Jorkut, do të drejtojë një kompani për blerje të veçanta.

MËSUESJA DHE TINI

Sa bëjnë 5+5 të keqen mësuesja?

Tini i numëron me gishta: 10 mësuese. Mësuesja e pa dhe i thotë: Tini, futi duart ne xhepa dhe tani më thuaj sa bëjnë 5+5?

Tini: Tani më dalin 11 mësuese!



Prindërit dinë diçka që ti nuk e di. Ndoshta, para se të lindje ti, prindërit e tu nuk kanë qenë aq të mërzitshëm sa janë sot.

(BILL GATES)



KALENDARI HISTORIK 24 MAJ



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS